

## **PROCESVERBALI**

Nga mbledhja VII-të e Kuvendit të Komunës, mbajtur më 31.05.2018, duke filluar nga ora 10:10, në sallën e Kuvendit të Komunës së Prizrenit.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm 38 anëtarë.

Të pranishëm ishin edhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, OSBE-ja, Zyra e EULEX-it, KFOR-it dhe përfaqësuesit e medimeve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Artan Abrashi, kryesues.

Për këtë mbledhje janë paraparë këto pika për:

## **R E N D D I T E**

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;**
- 3. Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme;**
- 4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimvendimit për Binjakëzimin e Komunës së Prizrenit, me Bashkinë e Beratit, të Republikës së Shqipërisë;**
- 5. Informatë mbi Planin e punës së Prokurimit për vitin 2018;**
- 6. Informatë mbi Planin e punës së Auditorit të Brendshëm, për vitin 2018;**
- 7. Shqyrtimin e raportit financiar të realizimit të Buxhetit Komunal, për tremujorin e parë të vitit 2018;**
- 8. Informatë mbi gjendjen e furnizimit me ujë në Komunën e Prizrenit;**
- 9. Shqyrtimi i propozimvendimit për ndryshimin dhe plotësimin-riparcializimin e Planit Urban (tani të hollësishëm) për shpalljen e zonës së veçantë për Industri të Lehtë (të mesme dhe të vogël) “Parku i Biznesit”;**
- 10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimvendimit për formimin e Komisionit Komunal të aksionareve nga Komuna e Prizrenit për Ndërmarrjen Publike Lokale, KRM "Eko Regjioni", Sh.A, Prizren;**
- 11. Informatë mbi Draft rregulloret si: 1. Draft rregullorja për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, 2. Draft rregullorja për regjistrimin e fëmijëve në klasën e parë të shkollës fillore, 3. Draft rregullorja për rendin ditor të shkollës, 4. Draft rregullorja komunale për vlerësimin**

**pedagogjik te fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore dhe funksionimin e ekipit vlerësues pedagogjik dhe 5. Draft rregullorja komunale për nxënësit e riatdhesuar.**

**Pika e parë:**

**Miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e Kuvendit të datës 24.05.2018**

**Kryesuesi,** e hapi debatin lidhur më procesverbalet, duke pyetur se a ka dikush për të shtuar diçka rreth procesverbalit?

**Simir Krasniqi (PDK):** Theksoi se në procesverbal mungon pjesa e debatit në mes Dafina Bllacës, kuvendare e PDK-së dhe drejtorit të Financave Ertan Simitçi.

**Kryesuesi:** Sipas rregullores të punës së Kuvendit, në qoftë se polemika, diskutimi është bërë me mikrofonta të mbyllur, ato nuk regjistrohen. Nëse është bërë, ajo vërtetohet në audio incizim. Kërkoj nga Shërbimi i Kuvendit që ta merr parasysh këtë kritikë apo vërejtje që u dha nga kuvendari. Atëherë ju ftoj që ta hedhim në votim procesverbalin e mbledhjes së kaluar. 38 anëtarë jemi në sallë, kush është për?

Për? – 29.

Kundër? – S’ka.

Abstenim? – 9.

Atëherë, konstatojmë se me 29 vota për, asnjë kundër dhe 9 abstenime është miratuar procesverbali i mbledhjes së kaluara.

**Pika e dytë:**

**Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës të propozuar**

**Kryesuesi,** a ka dikush të shtoi diçka për rënd dite të cilin e kemi paraparë në mbledhjen e fundit të KPF-së.

A ka dikush diçka të shtoj rreth rendit të ditës?

**Ganimete Hoxha Babuna (Nisma Socialdemokrate):** Të gjithë besimtarëve mysliman ua uroj muajin e Shenjt të Ramazanit. Propozoi që pika e tretë e rendit të ditës të hiqet nga kjo seancë, sepse merr shumë kohë dhe për ata që janë duke agjëruar, do të jetë një ditë mjaftë e vështirë. E di që është e vetmja pikë që na jep të drejtën të ngrisin çështjet që kanë të bëjnë direkt me qytetarët. Pra, sot i lus kolegët kuvendarë, që ato që kanë planifikuar ti ngrisin,

ti dorëzojnë me shkrim. Apo mundësia tjetër është që ky rend i ditës të shkurtohet, do më thënë kjo seancë të ndahet në dysh. Sot të mbahet një pjesë dhe javën tjetër apo pas Bajramit një pjesë tjetër.

**Kryesuesi:** Rendi i ditës është bërë sipas ligjit dhe rregullores së punës së Kuvendit. Aty përcaktohet si pikë e rendit të ditës, të cilën nuk mund të tejkalohet. Prandaj më vjen keq por duhet të vazhdojmë ashtu siç është paraparë edhe me kohë kur janë dërguar materialet, edhe me propozimet e KPF-së, por edhe me Rregulloren e Kuvendit. A ka dikush diçka tjetër?

**Kastriot Krasniqi (PDK):** Kërkoj që kjo seancë të shtyhet dhe të mbahet pas orës 14.30, pasi që është përvjetori i epopesë së lavdishme të Gorozhupit.

**Alush Shala (PDK):** Gjithashtu edhe unë i bashkohem propozimit të Kastriotit që kjo seancë të ndërpritet për mundësin e vazhimit, ku orarin të caktojnë shumica. Kjo datë është nën menaxhimin e kryetarit të Komunës. Realisht i bie shumë keq apo ne një mënyrë është një lloj bojkotimi. Që unë nuk po dua as me mendua as me besua që është e tillë. Ndërsa sa i përket pikës së tretë pyetje dhe përgjigje, ju nuk e lexuat fare. Kjo nuk ishte e mirë, apo ndoshta ishte edhe arsyeja që kolegja më parë e potencoj dhe kërkoj që të hiqet. Gjë që natyrisht nuk duhet të hiqet. Pastaj edhe në KPF-ca, kemi diskutua për pikën e fundit, që i takon Drejtorisë së Arsimit. Mungesa e sqarimit të drejtorit në KPF-ca. Po gjithsesi jemi marrë vesh pas sqarimeve që do të na jep drejtori. Natyrisht që do të përkrahet çka është në të mirën e fëmijëve dhe nxënësve tanë.

**Fatmir Kastrati (AAK):** Kërkoj sqarime se përse është hequr pika lidhur me shqyrtimin e propozimvendimit për formimin e komisionit komunal të aksionarëve nga komuna e Prizrenit për ndërmarrjen publike lokale Stacioni i autobusëve, a ka ndonjë arsye? Apo...

**Kryesuesi:** Theksoi se sa i përket pyetjes në lidhje me manifestimin në Gorozhup, unë me vonesë jam informua për këtë aktivitet. Dhe rrjedhimisht siç e kërkon edhe linja institucionale, Komuna e Prizrenit e njeh si autoritet të vetëm për organizimin e manifestimeve, që kanë të bëjnë me datat e përkujtimeve. Vetëm organizatat e dala nga lufta në Prizren, Organizatën e Veteranëve të Luftës, Organizatën e Invalidëve të Luftës dhe Organizatën e familjarëve të Dëshmorëve. Në protokollin e organizimit të tyre nuk figuron një manifestim i tillë. Ne si institucion e kemi një linjë të komunikimit dhe ajo linjë e komunikimit është vetëm me degët e organizatave të dala nga lufta në Prizren. Pra rrjedhimisht ne duhet të vazhdojmë me mbledhjen, pasi ne nuk kemi marrë ndonjë informatë nga këto organizata. Sa i përket çështjes së z. Kastrati. Në mbledhjen e fundit të KPF-ca, shumica e anëtarëve janë pajtuar që kjo pikë e rendit të ditës të lihet për mbledhjen e ardhshme, pra të shtyhet. Sepse kur po

flasim për ndërmarrjen në fjalë, fare pak kemi informata mbi atë se si ka funksionuar kjo ndërmarrje, çfarë pune është bërë aty, kush është pjesë e bordit, a kanë dorëzuar raport financiar, çfarë performace ka. Jemi në terr të plot sa i përket ndërmarrjes në fjalë. Dhe rrjedhimisht derisa ti kemi informacionet e plota, të cilat do ti paraqiten KPF-së, do ti paraqiten Kuvendit, si dhe organeve kompetentë që do ta trajtojnë këtë çështje. Ky komision komunal i aksionareve, mund të pret deri në mbledhjen e radhës. Ka qenë propozim i anëtarëve të KPF-së, i cili është votua pothuajse unanimitisht nga anëtarët e KPF-së. Kurse sa i përket pyetjes nga z. Alush Shala në lidhje me pikën e tretë pyetje dhe përgjigj. Është në rend në rend të ditës, ndoshta nuk e përmenda, por do të vazhdojmë sipas rendit të përcaktuar. Atëherë nëse nuk ka diçka tjetër, ftoj që ta miratojmë këtë propozim për rend dite. 38 anëtarë jemi në sallë, kush është për?

Për? – 33.

Kundër? – S'ka.

Abstenim? – 5.

Atëherë konstatoj se me shumicë votash aprovohet rendi i ditës i propozuar.

### **Pika e tretë:**

#### **Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme**

**Kastriot Krasniqi:** Parashtroi pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike. Në rrugën “Hysen Rexhepi” te Qafa e kishës, te trotuari kanë gjet në formë të ndalesës së parkingut me ngjyrë të kuqe. Është një vendim i Kuvendit, që përreth zonës historike të Prizrenit, gjithçka që punohet, të punohet në formë të drurit. Jo siç e keni bërë ju drejtor. Prapë pyetja për Drejtorin e Shërbimeve Publike në lidhje me çështjen e ujit në lagjen e UÇK-së. Ju në fushatë keni premtuar si ta marrim mandatin, brenda tre muajve do ta rregullojmë këtë çështje. Megjithëse na keni kritikuar shumë se për dhjetë vjet nuk e kemi bërë. Ju nuk keni ndërmarr asgjë brenda këtyre tre muajve, pas premtimit që keni bërë. Po ashtu në të njëjtën lagje është një mur mbrojtës, ku rrezikon diku dhjetë familje. Aty nuk kanë qasje për të hyrë në shtëpitë e tyre. Ata i kanë parashtruar mbi gjashtë- shtatë kërkesa, mirëpo nuk e ka marrë askush parasysht.

**Simir Krasniqi:** Në emër të grupit parlamentar të PKD-së në Prizren shpreh shqetësimin e thellë ndaj aktit të rrënimit të disa objekteve në qytetin e Prizrenit, nga ana e komunë së Prizrenit ditë më parë. Duke mos përfillur asnjë procedurë legale. Monumentet e shkatërruar nga ana e komunës së Prizrenit, duke mos respektuar asnjë procedurë, kanë qenë monumente të arkitekturës së vjetër. Me vjetërsi mbi 100 vjeçare, dhe atë në zonën mbrojtëse. Kjo e cila është propozuar nga grupi punues për hartimin e planit të menaxhimit të qendrës

historike në Prizren, ku komuna e Prizrenit përfaqësohet në atë grup. Po ashtu ndërtesat në fjalë kanë qenë në proces të vlerësimit. Dhe në kuadër të procesit të përgjithshëm të inventarizimit për tu përfshirë në listën e trashëgimisë për mbrojtje. Duke qenë kështu, grupi parlamentar i PDK-së, vlerëson se komuna e Prizrenit, është dashur domosdoshmërisht të konsultohet me Qendrën Rajonale për trashëgimi kulturore. Institutin e Kosovës për mbrojtjen e monumenteve dhe Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Lidhur me rastin e fundit ku komuna e Prizrenit pa marr pëlqimet dhe aprovimet e nevojshme nga institucionet përkatëse të trashëgimisë kulturore, Qendra rajonale për trashëgimi kulturore dhe Instituti i Kosovës për mbrojtjen e monumenteve. Ne si kuvendarë të PDK-së, e konsiderojmë veprim të kundërligjshëm që cenon vlerat e trashëgimisë kulturore në Prizren. Andaj duke u marrë për bazë të gjitha këto që u thanë më lartë, në emër të grupit të kuvendarëve të PDK-së, kërkoj nga organet e rendit të që iniciojnë procedurën e një hetimi ndaj atyre që kanë marrë këto veprime të jashtëligjshme në qytetin tonë. Ku të gjithë ishim prezent, shefja e BE-së Apostolova, tha që do ta rregullojmë rrugën “Marlin Barleti” dhe do ti rinovojmë disa shtëpi të vjetra. Ndoshta nga ju tash nuk ka nevojë ti rinovoni, por ne i rrënojmë ato shtëpi të vjetra, sikur në këtë rast. Qendra historike duhet të ruhet dhe është e mbrojtur me ligj. Nuk bënë kurrsesi të shkatërrohen, të rrënohen në atë mënyrë sikur se janë rrënuar më herët. Gjithashtu e pyes Kryetarin, cili është roli i policisë në komunën e Prizrenit. Nga kush është kërkuar që policia e Kosovës të qëndroj para dyerve të Kuvendit komunal. Ku kjo po reflekton jo mirë para qytetarëve të komunës së Prizrenit. Ku qytetarët e komunës së Prizrenit kanë një kulturë, kanë një traditë. Dhe jo mirë reflektimi i policisë para dyerve të Kuvendit komunal.

**Agnesa Sinanaj (AAK):** Kam vërejtje për ndarjen buxhetit të organizatave joqeveritare nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport. Sepse janë paraparë të ndahen 250.000,00 € për OJQ-të e ndryshme dhe një numër i këtyre organizatave nuk dihet se çfarë aktivitete bëjnë edhe çfarë të mira përfiton komuniteti prej punës së këtyre. Kërkoj të bëhet publike cili komision e ka bërë këtë përzgjedhje. P.sh shoqatës vullkoniste e muzikës turke i janë ndarë 1.500 €, Filizler TKSD 3.000 €. Këto shoqata nuk krahasohen me shoqatën kulturore artistike “Agimi” dhe Lidhjen e Prizrenit, të cilët e përfaqësojnë Prizrenin në festivalet ndërkombëtare. Do më thënë janë barazua me OJQ-të që nuk kanë ndonjë aktivitet, se unë as nuk i njoh këto OJQ. Plus asaj ka edhe emra individësh, a janë ndarë edhe për individ edhe në çfarë mënyre. Pse janë ndarë këtyre dhe çfarë aktiviteti kanë pas këta individ. Nëse ka mundësi me ma shpjegua i nderuar kryetar edhe drejtori.

**Illir Baldedaj (AAK):** Unë dua ta ngris çështjen përsëri të teleferikut. Kryetarit të komunës vazhdimisht ia kam tërheq vërejtjen, sepse ke bërë shkelje ligjore dhe keni ndërhy në mënyrë arbitrare në Zyrën e Prokurimit. Dhe a jeni në dijeni që organi shqyrtues i Prokurimit ua ka kthye në rivlerësim dhe nuk keni të drejtë as të ankoheni. Dhe a po ja shtoni komunës së Prizrenit edhe një lëndë në gjykatë në Prizren, sepse vazhdimisht jeni ankua për padi të mëdha. A duhet të jepni dorëheqje sepse keni thënë se ne kur të vijmë në pushtet nuk do të shkelim ligjin. Do ti respektojmë të gjitha procedurat. Jo veç kjo shkelja ka përplot shkelje të tjera të cilat i keni bërë për këto gjashtë muaj të qeverisjes. Pyetja e dytë është nënshkrimi i kontratës së pishinës olimpike pa zotim të mjeteve. Nëse keni zotim të mjeteve ju kisha lut ta publikoni. Sepse nuk guxon asnjë investim kapital të nënshkruhet kontratë pa pas mjete të zotuar. Çështja tjetër është transiti, të cilën partneri i juaj qeverisës ka thënë që në ditët e para unë do ta largoj atë shtëpi. Apo ndoshta ka qenë militant i LVV-je në fushatë, dhe ju ka bo vota dhe tani hezitoni ta përfundoni atë çështje te transiti. Nëse ju thoni se nuk është militant i VV-së, unë kam argumente dhe foto të cilin deputeti i juaj e falënderon për kontributin e dhënë për mbledhjen e votave po atë person, i cili e ka bllokuar Prizrenin tash e sa kohë. A duhet të ndiheni përgjegjës për fjalët publike që i keni dhënë gjatë fushatës zgjedhore për të cilat deri më sot asnjë nuk e keni zbatua. Duke filluar nga ekzekutivi 50-50, nga shkeljet e ligjit dhe çështjeve tjera. Unë kërkoj që kryetari i komunës të mos jetë peng i qytetit të Prizrenit. Sepse ndoshta ata 260 qytetarë që të kanë votua ty, kanë besua që ti do ta largosh atë shtëpi. Ndërsa tash e gjashtë muaj, ata 260 qytetarë që kanë besua në ndryshim, janë të zhgënjyer dhe besoj se duhet ti keni të çarta çështjet. Sepse kryetari i komunës nuk guxon të ndërhy në organet të cilat nuk janë në kompetencën e tij. Andaj, Kryetar është mirë të dorëhiqësh dhe ta lirosht Prizrenin nga kjo katrahurë që e keni katandisur.

**Karanfil Haxhillari (LVV):** Parashtroi pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Deri ku ka arritur vlerësimi i komisionit për ndarjen e materiali ndërtimor, për ndërtimin e shtëpive të familjeve skamnore. Si dhe çfarë forme do të jetë nga komuna kjo ndihmë. Duke pas parasysh që nga qeverisjet e kaluara, ky projekt, apo ky subvencionim është keqpërdorë në format më makabre. Duke i ndarë subvencione për 80 familje, kurse kanë përfituar, apo janë ndërtuar vetëm 5 shtëpi. Pyetja tjetër është për Drejtorin e Urbanizmit. Ne të gjithë jemi të vetëdijshëm për katrahurën urbanistike që është në qytetin e Prizrenit. Mirëpo, jemi dëshmitar që kanë ardhur udhëzime administrative për ndërtimin e ndërtesave të larta në kundërshtim me ligjin. Pra, përmes udhëzimeve administrative të cilët e shkelin drastikisht ligjin. Po e marrë si shembull vetëm me ligjin për ujërat. Ku neni 48 pika 1.3 ndërtimi i

objekteve të larta të cilat nuk shërbehen për mbrojtjen nga përmbytjet, në lartësi prej së paku 30 metrave nga shtrati i lumit. Pra, ndalohet me ligje, nga ligji për ujërat neni 48. Pyetja për Drejtorin është, a e keni shqyrtuar mundësinë dhe të drejtën që ua jep ligji për pezullimin e lejeve ndërtimore të cilët shkelin drastikisht këtë ligj.

**Behar Begaj (LDK):** Unë kam një pyetje për Drejtorin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. I bashkëngjitem koleges në fjalët e mëparshme znj. Agnesa Sinanaj. Ne në Zhur kemi klub futbollistik i cili ka filluar garat në ligën e dytë të kampionatit të Kosovës dhe tash është përfunduar ky edicion. Dhe kryesia e klubit ka bërë një kërkesë, që ta mbështesë me mjete financiare. Por një gjë e tillë nuk ka has në mirëkuptim. Unë së bashku me presidentin e klubit z. Ajazaj kemi kontaktua edhe drejtorin dhe kemi thënë që kjo shumë e ndarë nuk është e pranueshme për klubin dhe nuk e përmbush asnjë kërkesë të këtij klubi. Kam marrë një përgjigje nga drejtori, ku thotë se klubi futbollistik të Zhurit i janë ndarë 3.000 € si subvencion. Gjë të cilën ne nuk e kemi kërkuar si subvencion. Ne kemi kërkuar një mbështetje nga ky dikaster. Dhe drejtori thotë që shuma më e lartë për subvencione është 3.000 €. Unë nuk pajtohem me këtë, sepse nuk kam asgjë nga sportet e tjera, apo shoqatat kulturore. Por dihet se si subvencion i është ndarë "DokuFest"-it 10.000 €. Atëherë këtu paska shkelje nga kjo drejtori, përderisa e ka kaluar shumën 3.000 €, ka shkua në 10.000 €. Andaj, kërkoj sqarime nga drejtori që ta jep para nesh këtu, se ku shkojnë këto mjete 10.000 € për "DokuFest", ku shfrytëzohet dhe nga kush shfrytëzohen. Kërkoj nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, që të merret më çështjen e ujit të pijes në Zhur, sepse kanë filluar të kenë problem që nga muaji i kaluar. Janë ndarë mjetet për shtimin e sasisë së ujit dhe ndërrimin e pompave, që janë dy pompa ekzistuese, të shndërrohen në një pompë, por me një kapacitet më të madh. Andaj, ta merrni këtë çështje me seriozitetin më të lartë dhe të fillojnë sa më parë këto punime, që qytetarët të kenë ujë të mjaftueshëm për pije. Çështja tjetër është rreth shtëpisë së kulturës, ku këtë ia adresoj kryetarit. Para disa jave e kam pas një komision nga Fakulteti teknik i Prishtinës, dhe e ka pa se në çfarë gjendje është shtëpia e kulturës. Ai më sa kam njohuri e ka bërë një raport dhe më siguri që ua ka dorëzuar juve atë raport. Dhe kërkohet që këtu të plotësohet ai kriter i cili është kërkuar nga ky dikaster. Unë mendoj se duhet të plotësohet ajo kërkesë nga ai ent, që të bëjë ekspertizën dhe të zbardhet një çështje shumë madhore e cila ka të bëjë me investime marramendëse mbi 1.000.000 €, që mos ta them shumën e saktë se nuk jam në dijeni se sa janë investuar. Në fund kërkoj që ta ftoni në seancën e radhës shefin e prokurimit z. Isa Osmankaj, që të jep raport se ku ka përfunduar çështja e teleferikut.

**Mimoza Bushrani (LVV):** Brenda një jave Prizrenin e tronditen dy ngjarje tragjike. Dy të reja nxënese të shkollës së mesme kanë kryer vetëvrasje. Besoj se të gjithë këtu por edhe mbarë qytetarët bashkë ndiejnë dhimbje me familjaret e këtyre dy vajzave. Po ashtu të gjithë prindërit që i kanë fëmijët në moshë adoleshente dhe vijnë shkollimin para universitar më plotë të drejtë janë të shqetësuar. Andaj e pyes Kryetarin dhe Drejtorin e DKA-së, cilat janë masat që i kanë ndërmarrë për hulumtimin e këtyre dy rasteve. Apo do të ndërmarrin për të parandaluar raste të këtilla të kobshme dhe që ngjarje të këtilla si këto mos të ndodhin më në mesin tonë. Pyetje tjetër të radhës është për Drejtorin e Urbanizmit. A keni bërë ndonjë vlerësim të numrit të objekteve të ndërtuara në komunën e Prizrenit. Për të cilat është shkelur ligji për ndërtim si dhe ligji për ujërat. E kam fjalën për ndërtim në shtratin e Lumëbardhit. Konkretisht cilat janë veprimet që i keni ndërmarrë për raste të identifikuar të shkeljeve ligjore.

**Alush Shala (PDK):** Fillimisht i bashkohem dhimbjes së koleges që shprehu për rastin e vdekjes së dy nxënësve. Njëkohësisht kërkoj që të nderohen këto dy familje më një minutë heshtje. Kërkoj që të na raportohet në lidhje më këto dy ngjarje, sepse vërtetë ka shkaktuar dhimbje jo vetëm në komunën tonë, por në mbarë rruzullin ku është dëgjua për këto raste. Si dhe mundësin e ndaljes së këtyre veprimeve. Kërkoj që të bëhet dezinfektimi në lagjen Dardania, sepse insektet po paraqesin rrezikshmëri sidomos tek fëmijët. Jam në dijeni që është procedurë për spërkatjen në tërësi të komunës. Por po ju njoftoj se mirë kishte me qenë me marrë veprime paraprake qoftë edhe në mënyrë të veçantë. Prapë e përsëris kërkesën për largimin e automjeteve të cilat janë në çdo hyrje të qytetit, automjetet të cilat bartin kufoma. Ato nuk lëvizin, vetëm janë për reklama. Së paku a paguajnë tatim për reklamat që i bëjnë në çdo hyrje të qytetit. Shqetësuese është Në veçanti shqetësuese është të ish Benafi që është bërë një varrezë makinash, një varrezë mbeturinash. Është një pasqyrë shumë e keqe për komunën e Prizrenit. Pyeti Drejtorin e Arsimit se çka është bërë dhe deri ku ka shkuar procesi mbi ndërtimin e shkollës së Muzikës, e cila e ka marrë një vendim në Kuvend në vitin 2017. Desha të pyes kryesues juve, po përmes juve njerëzit kompetent ndoshta drejtorin e Kulturës. Para nja tri jave ka ndodh një fenomen që është mbuluar komplet Shtëpia e Lidhjes së Prizrenit nga një grup valltarë a nuk e di çka kanë qenë, me një ngjyrë, pa dashtë me ofendua asgjë, po që i bije ngjyrë LGBT, e kuptojnë besoj të gjithë. Mirë është me na thënë pse. Nuk kisha pse qejf me ndodh me një monument siç Shtëpia e Lidhjes së Prizrenit, e çfarë rëndësie ka, jo për PDK-në kuptohet, po mbarë kombin shqiptar. Ne edhe në seancën e kaluar kemi biseduar për çështjen e drejtorit të Financa të z. Ertan Simitçi, dhe kemi kërkuar që të kërkoj falje, jo pse ka fol



turqisht, po pse në fakt ka bërë një lëndim këtu. Pastaj le të krijohen kushtet që ne ti kuptojmë edhe atë që thuhet në gjuhën turke, se ne nuk ia mohojmë. Por edhe një komunikatë drejtori e ka dërguar në gjuhën turke. Prapë nuk jam kundër pse ka dërgua komunikatën në gjuhën turke. Po gjuhë zyrtare është edhe gjuha shqipe, edhe ai është i detyruar ti qetë në dy gjuhët, më sa e njohë unë Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Po që se kërkon falje, mendoj që drejtori do të fiton apo do ta rifiton respektin që ka pas jo nga unë po nga të gjithë anëtarët e PDK-së. Të cilët edhe në mandatin e kaluar e kemi respektuar këtë drejtor.

**Kryesuesi:** Vetëm ti ftoj anëtarët e Kuvendit që të jenë sa më të shkurtë, koha për këtë piktë të rendit të ditës është vetëm dy minuta. Mund të zgjatë ndonjëherë për me përfundua fjalinë. Por ta kemi parasysh rregulloren që mos ta tejkalojmë atë. Kurse sa i përket pyetjes lidhur me Kompleksin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, që janë vendos panelet aty. Ai kompleks është komplet në kompetencat e Ministrisë së Kulturës. Merret në shfrytëzim me leje të Ministrisë së Kulturës. Edhe unë jam shumë kureshtarë me ditë përgjigjen në vendosjen e atij baneri, sepse përgjigja nuk është tek adresa e komunës së Prizrenit.

**Petrit Hoxhaj (LDK):** Kam dy pyetje që do tu drejtohem sot kabinetit. Mirëpo, njëra ka të bëjë me Drejtoreshën e Shëndetësisë. Ju gjatë fillimit të muajit maj bashkë me drejtorin QKMF-së dhe një grup të punëtorëve të QKMF-së, me paratë e taksapaguesve të Prizrenit, keni qëndruar në Ulqin tri ditë. Ju lutëm cila ishte arsyeja e qëndrimit dhe nga kush e morët vendimin që pagesa të bëhet nga buxheti i komunës. Këto praktika i ka ndjekur pushteti i kaluar. Mendoj se kjo është keqpërdorim i parasë publike. Nga informatat që kam është i njëjti grup që shkon çdo vit me buxhetin e Kuvendit komunal. Ku ne të gjithë e dimë se QKMF-ja ka diku 475 punëtor. Ndërsa të privilegjuar janë veç 30, të cilët për çdo vit në të njëjtën kohë e kanë marrë këtë vendim që shkojnë. Nëse është arsyetim se kanë qenë dhe kanë marrë pjesë në vizitat sistematike nuk qëndron. Pasi që aty ka edhe të sishit të ajtisë të vaksinimit etj. Ju lutëm drejtoreshë të na tregoni sa ka qenë shpenzimi i këtij buxheti. Pyetja tjetër ka të bëjë me drejtoreshën e Turizmit znj. Sevil Kazaz, po nuk qenka këtu. Qyteti i Prizrenit është shpallë qytet Historik i Kosovës. Çfarë është duke bërë kjo Drejtori për promovimin e vlerave historike të Prizrenit. Mendoj personalisht është njëra ndër drejtorit më pasive që ka pas qyteti i Prizrenit. Nuk e di ku është arsyeja e këtij pasiviteti. Pasi se qytetin tonë e vizitojnë me qindra turist të huaj. Kjo Drejtori a ka ndonjë statistikë se sa është numri i vizitorëve që e vizitojnë qytetin. Dhe çka është duke bërë kjo Drejtori rreth promovimit të vlerave historike, kulturore tek ata turist. Ndërsa kryesues këtu pranë vetës kam një kërkesë direkt për juve. Ka të bëjë për blerjen e laptopëve. Ne mendojmë se

është e domosdoshme kjo, pasi që është mjet i punës për neve dhe pas seancës do t'ua dorëzoj personalisht kërkesën edhe nënshkrimet e kuvendarëve.

**Cenet Sajadi (KDTP):** Teşekkürler Başkan hepimizi saygı ile selamlıyorum. Belediye Başkanına ve bütün müdürlere bir sorum olacak, lütfen talebim olacak aslında Belediye tarafından yapılan ilanlarda asılan afişlerin Türk dilinde de olmasını talep ediyorum eğer tercüman eksikliği varsa tercüman alalım belediyeye bir de Kamu Hizmetleri Müdürüne bir sorum olacak Shpend Berisha ve Recep Bajraktari gibi mahallelerde elektrik sayaçlarının direklerle asılmasından vatandaşlar şikayetçi elektrik sayaçlarının evlere asılmasını talep ediyorlar teşekkür ederim.

Kërkoj nga kryetari i komunës dhe të gjithë drejtorët që afishet e postuara nga Komuna të jenë edhe në gjuhën turke. Nëse ka mungesë të përkthyesve atëherë le të merren përkthyes të ri. Kam një pyetje edhe për Drejtorin e Shërbimeve Publike. Tek mëhalla "Shpend Berisha" dhe "Regjep Bajraktari" njehsorët e rrymës elektrike janë vendosur në shtylla dhe për këtë qytetarët ankohen dhe kërkojnë që njehsorët të vendosen nëpër shtëpia.

**Vjollca Kabashi (AAK):** Parashtroni pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike. Me çfarë standardi të kualitetit të ngjyrës shejzohen apo ngjyrosen vijat horizontale në komunikacion. Sidomos vijat e kalimit për këmbësor, të cilat janë fshirë për një kohë shumë shkurtës. A ka organ mbikëqyrës komuna dhe çfarë masa keni ndërmarrë për këtë punë jo kualitative.

**Rreze Hoxha (PDK):** Sot unë e kam një kërkesë nga banorët e lagjes Bazhdarhane, kryesisht rruga Mbretëresha Teuta. Nga Drejtoria e Shërbimeve Publike kërkojnë që të intervenoj në këtë lagje për ndriçimin publik. Ku njëkohësisht aty tek ish pazari i bulmetit, që ka qenë më herët. Ku tani është një park të cilin nuk mund ta shfrytëzojnë banorët e lagjes për shkak të mos sigurisë dhe mos mirëmbajtjes. Aty shfrytëzohet nga një grup i madh narkomanësh, të cilët janë shqetësues për banorët e lagjes. Andaj kërkoj nga Drejtoria e Shërbimeve Publike që të marrin masa që të ndërhyjnë në këtë lagje.

**Sherife Balaj (PDK):** Me reagimin që kam pa prej kryetarit të komunës, disa ditë më herët në rrjetet sociale, madje edhe disa portale të tyre edhe e kanë mbështetë. Është kështu, për herë të parë në Prizren, komuna shpërndanë pako ushqimore për familjet skamnore. Nuk kisha dashtë me bo polemika, nuk kisha dashtë me bo politikë për këto raste. Po, nuk mundeni mi rrejt qytetarët e Prizrenit, nuk mundeni me rrejt askënd, sepse ne tek e fundit hala jemi gjallë. Hulumtoni në ueb faqen e komunë asnjë vendim të vitit 2017, se jo vitet paraprake, nuk mundeni me gjet. Gjithçka ka startua në qytetin e Prizrenit

vetëm kur këta kanë ardhur në pushtet, do më thënë prej vitit 2018. Atëherë, ju sqaroi se në vitin 2017, në komunën e Prizrenit nga buxheti i komunës gjegjësisht nga DPMS-ja janë ndarë për pako ushqimore për 158 familje. Këto janë fakte të cilat mbesin. Nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale me iniciativën tonë janë ndarë pako me veshmbathje për 200 familje të skemës sociale të Prizrenit, të organizuar nga OJQ "Jetimat e Ballkanit" dhe me takimet të cilët i kemi pas një pas një me bashkëpunimin e mirë që kemi pas me ta. Kanë organizua dhe kemi shpërnda veshmbathje për 500 familje po të kësaj kategorie nga SAS-i. Duke mos anashkaluar mbështetjen me 50.000 € të komunës së Prizrenit për kuzhinën popullore, që është aktive tek qendra "Jetimat e Ballkanit". Këtë e kemi bo si pushtet vitin 2017. Edhe sot e asaj dite besoj që po vazhdon edhe qytetarët janë të kënaqur me funksionimin e saj. Me bashkëpunimin dhe marrëveshjet që kemi pas me bizneset në Prizren kam bo iniciativ edhe kemi arrite bashkëpunimet, sidomos me kompaninë Prizren Commerc Group, ku kemi nda për 50 familje pako ushqimore. Kjo në total i bje 908 familje janë mbështet prej skemës sociale. Që kryetari nuk e dinë, po nuk e di a e dinë edhe drejtori tash i Mirëqenies Sociale. Që në skemën sociale janë 1800 familje. Skema sociale nënkupton SAS-in, që përfshinë vetëm familjet të cilët nuk kanë mbështetje financiare të mjaftueshme për kaluar muajin. I bie 908 familje, prej 70 familjeve që i kanë mbështetë sivjet. Është bërë një polemikë e madhe që po i mbështetin. Krahasoni tash ju më një logjikë shumë thjeshtë, 70 me 908 familje. Plus të tjerat të cilat nuk i kemi në evidenca, por janë ndihmua dhe janë prek të gjitha familjet. Do më thënë kjo është iniciativë e viteve të kaluara. Dhe ju vazhdoni me i ndihmua e mos boni kësi propaganda. Mos boni zhurmë në fakt për asgjë. Më kujtohet zhurma që është bërë për objektin e ri të shkollës fillore në Gjonaj, u patë përurua dy herë ai objekt. Është investim për mu krenua, edhe ka qenë shumë i nevojshëm, dy herë është bërë përurimi. Madje u pat politizua aq shumë sa që thoshin, jo është i nevojshëm, jo s'është i nevojshëm. Po atë e dinë vetë fshatarët. Ndërsa tek objekti shkollës fillore në fshatin Dedaj i cili është përfunduar, ku fëmijët mbajnë mësim dhe ende as nuk është përuruar, nuk është pranuar teknikisht. Në një farë forme ai është jo legjitim. Ndërsa zhurmat vitin e kaluar u behshin pse po pranohen teknikisht edhe pse po përurohen nga dy herë. Më tregoni tash mua se është më mirë mu përurua dy herë, apo asnjëherë, tash qysh po ndodh dhe mos mu pranua as teknikisht. Do më thënë ne nuk e dimë sigurinë në atë shkollë se ku mundemi me has nesër apo pasnesër. Edhe një pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike. Çfarë është duke u bërë me mjetet e ndara nga Ministria e Infrastrukturës për rrugën Mazrek-Gjonaj-Bistrazhin të Prizrenit. Në fakt kjo linjë buxhetore i takon, edhe pse përfshinë një pjesë të rajonit të Gjakovës. Po shumica është në rajonin e Prizrenit. Dhe kjo kompetencë i bje që ta menaxhoj me këtë shumë

komuna e Prizrenit. Janë ndarë 50.000 € në kodin 15368 në vitin 2017. Ndërsa për rrugën Rugovë-Has-Prizren me kodin e projektit 15371 në vlerë po ashtu 50.000 €, që i bije 100.000 € në total. Prej informacioneve që kam tash Ministria e Infrastrukturës, ka ndarë një shumë tjetër bashkëngjitëse me 350.000 €, për vitin 2018. Edhe kisha dashtë me ditë prej drejtorit a e ka këtë informacion, a i ka gjet këto marrëveshje që i kanë pas në këtë linjë buxhetore. Dhe çka është duke u bo në këtë drejtim. Sepse qytetarët tashmë janë të informuar pak a shumë të rajonit të Hasit për këtë renovim të rrugës që i bije me një gjatësi gati 40 kilometra. Dhe e dimë kur është përfundua ajo rrugë me vite të tëra gati 15 vite u bënë prej asaj kohe. Është dëmtuar aq shumë sa që ka nevojë për renovim. Desha me u ndërlihd edhe te shpërndarja e mjeteve për OJQ-të në Drejtorinë për Punë dhe Mirëqenie Sociale. Pyes Drejtorin e Mirëqenies Sociale, a është bërë komision për ndarjen e këtyre mjeteve dhe a ka qenë gjithë përfshirja në komision për këtë shpërndarje. Sepse ne e dimë se duhet me pas një konkurs edhe një njoftim për ndarjen e mjeteve të komunës. Dhe a kanë marrë pjesë të gjithë ata aktoret që kanë të drejtën e ndarjeve të këtyre mjeteve, e kam fjalën qoftë edhe pjesëtarë prej shoqërisë civile, ta dinë të informohen. Kush për çka po ndanë. Se po e shoh që ka OJQ, të cilat as nuk kanë licencë për veprim, e në fakt këtu janë ndarë shuma deri në 5.000 €. E kështu që duhet me ditë edhe me qenë të informuar për këto gjëra. Në fund pyes Drejtorin e Shërbimeve Publike, ndriçimi që ka mbet në gjysmë në rajonin e Hasit, në fshatra kur do të përfundojnë.

**Memnuna Ajdini (Vakat):** Najpre koristim priliku da čestitam svima koje slave ovaj mesec Ramazana, da ga u miru i saboru proslave, i da u veselju dočekaju prestojeći Ramazanski Bajram. Pitanje se odnosi za Direktorij za Jevne Usluge. I pitanje se tiče radova koji se izvode na magistralnom putu Prizren-Prevale, deonica Prizren-Kerkbunar. Kada je rok završetka. A pri tome želim dati predlog da se radovi izvode noću kada je frekvencija manja. I da se poveća broj radnika. Obzirom da je vrlo mali broj radnika koji tu rade. Jer postoji velika negovanja od strane učesnika u saobraćaju, zbog vrlo lošek stanja na putu. Ova deonica je dosta u lošem stanju. Gde jedna traka takoreći neupotrebljiva. Tako da vozači izbegavaju tu traku, i onda voze na onu drugu traku. Time se povećava rizik od saobraćajnih nezgoda. Očekujem da se radovi ubrzaju sa navedenim predlozima. Pre nego što krene letnja sezona. Kao i dolazak iz diaspore. Kada je ova saobraćajnica jako opterečena, to jest maksimalno opterečena.

**Kujtesa Kabashi (LDK):** Në vitin 2011, në fshatin Kushnin kanë përfunduar punimet në rrjetin e kanalizimit të ujërave të zeza. Mirëpo një pjesë e lagjes nuk kanë pas mundësi në kyçje, për shkak të pozitës gjeografike. Por

problemi më i madh është derdhja e këtyre ujërave në brendësi të fshatit ku rrezikon jetën e banorëve që jetojnë në afërsi. Derdhja e ujërave të zeza bëhet përafërsisht 100-200 metra nga shtëpitë. Gjithashtu derdhja e këtyre ujërave ndot edhe një pjesë të tokës bujqësore, ku bagëtitë janë në kontakt të përhershëm sidomos gjatë verës. Kërkoj nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, që të dërgoj një komision që të verifikoj gjendjen në terren dhe të gjendet një zgjidhje e përhershme e këtij problemi.

**Fatmir Kastrati (AAK):** Kryesues ne po më duket po dialogojmë me kuvendarët në mes nesh, po bëjmë pyetje. Nuk po dimë me dhënë përgjigje, se edhe përgjigje kishim me dhënë. Pse po e them këtë, sepse vetëm një përgjigje kemi pas me shkrim, nga pyetjet që i kemi shtruar në mbledhjen e kaluar. Nuk e di drejtorët a mbajnë shënime, a kanë obligim me na dhënë përgjigje. Se në qoftë se ne ato pyetje po i ngrisim këtu. Dikush po na thotë me i ngritë këto pyetje. Po çfarë përgjigje do ti japim atyre unë nuk di. Andaj kërkoj nga drejtorët që të jenë më aktiv, që të na japin përgjigje, të na dërgojnë përgjigje në mënyrë që edhe ne të dimë tu përgjigjemi qytetarëve. Në qoftë se vazhdon kështu, vetëm pyetje të bëjmë dhe mos të kem përgjigje, atëherë të hiqet si pikë e rendit të ditës. Se këtu po më duket vetëm me na pa dikush që po bëjmë pyetje edhe me këtë po përfundon. Kurse pyetjen e kam për Drejtorin e Arsimit. Si po shkon procedura në përzgjedhjen e drejtorëve të shkollave drejtor? Si është formuar komisioni vlerësues për këta drejtor? Kush janë anëtarë të këtij komisioni? Dhe a do ti zbatoni ato qëndrimet tuja që nuk do të zgjidhet drejtor politik? Po ashtu edhe një tjetër për Drejtorinë e Arsimit, nuk dua me politizua çështjen e rastit tragjik të nxënësve tona. Po së bashku me organet kompetente duhet një përgjigje. Në mënyrë që të ndalen spekulimet lidhur me këtë çështje. Ka spekulime nga më të ndryshmet, edhe akuzohen njerëzit edhe të fajshëm edhe të pafajshëm. Kurse sa i përket për ujin e pijes, do të bisedojmë në pikën e tetë ku është paraparë si pikë e rendit të ditës.

**Bardhi Avdaj (PDK):** Fillimisht të gjithë besimtarëve Islam i uroj muajin e shenjt të Ramazanit. Po bëhen gati tetë muaj të qeverisjes aktuale dhe ende nuk kemi një raport se çfarë është punuar dhe çfarë realizuar nga premtimet e fushatës zgjedhore. Unë si asamblistë kam pranuar disa kërkesa nga banorët e fshatit Malësi e Vrrinit. Këtu kërkesa janë parashtruar para katër muajve, që dëshmohet me numër të protokollit. Ju, jo vetëm që nuk i keni realizuar këto kërkesa, por as nuk keni gjetur kohë, së paku të prisni në takim dhe të jepni një përgjigje zyrtare kërkesave të parashtruara. Po e përsërisë edhe një herë disa kërkesa të parashtruara nga banorët e fshatit Malësi e Vrrinit, ku kryetari Lulzim Buniku i ka dorëzuar në drejtori përkatëse. Vendosija e tre mureve mbrojtëse në disa lagje të fshatit Malësi e Vrrinit. Sepse muret janë para

shembjes dhe është rrezik për fshatin. Funkcionalizimi i rrugës në dy lagje të fshatit e cila ndodhet në hyrje të fshatit dhe që do të shkarkonte tollovit e shkaktuara në hyrje të fshatit. Njëkohësisht tërheq vërejtjen se është muaji i katërt që këtyre kërkesave dhe kërkesave tjera që janë parashtruar nga kryetari z. Lulzim Buniku, dhe janë protokolluar po që nuk është dhënë asnjë përgjigje. Andaj kërkoj që këtyre kërkesave tu jepet përgjigje në kohë të caktuar dhe sipas afatit të paraparë me ligj.

**Kryesuesi:** Vetëm një përkujtim për anëtarët e Kuvendit. Për këtë pikë të rendit të ditës keni të drejtë vetëm njëherë ta merrni fjalën. Kjo është e rregulluar me rregullore. Prandaj më mirë përmbliidhni të gjitha keni me thënë. Sepse kjo është e pamundshme dy me marrë fjalën për këtë pikë të rendit të ditës. Se ashtu kështu është duke zgjatë edhe më shumë.

**Cengis Çesko (KDTP):** Sot po e realizoj fjalimin tim të parë në këtë kuvend, andaj ju kërkoj mirëkuptimin tuaj. Jam shumë i nderuar që sot gjendem në mesin tuaj. Kam kënaqësi shumë të madhe që bashkë me ju në këtë kuvend po punojmë për Prizrenin tonë të bukur, tani më Kryeqytetin historik të Kosovës. Si fillim kam disa pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike. 1. Në lagjen Bazhdarhane, konkretisht te Kullat gjendja e parkut është shqetësuese, dua të ju pyes se a ka ndonjë planifikim për ri-konstruktimin e parkut. Sipas informatave të mia, shoqata EC Ma Ndryshe po merret me dizajnimin e këtyre parqeve. A do të rinovohet parku të Kullat? 2. Në vitin 2016 komuna e Prizrenit ka bërë izolimi i ndërtesës te Kullat. Por, për shkak këto punimet nuk janë të kryer siç duhet madje janë lënë në gjysmë, qytetarët që po banojnë në katet e fundit janë të shqetësuar shumë, ata po ankohen nga izolimi i dobët. Duhet të merren masat e nevojshme në këtë drejtim. 3. Ndërtimi i stacioneve publike për autobusët, pranë universiteti dhe pranë dritave tek qendra tregtare ELKOS, kryesisht për këto vende qytetarët vazhdimisht po e shprehin shqetësimet dhe pakënaqësitë e tyre. Mendoj që këto stacione duhet të ndërtohen sipas standardeve evropiane. Në anën tjetër higjiena dhe pastërtia në autobusët urbane është shumë e dobët. Ju kisha lut që edhe për këtë dukuri të merren masat e nevojshme. 4. Në rrugën Hafiz Islamil Hakkı pas çdo shiu po mbliidhet një masë e madhe të ujit, gjë që po shkakton edhe përmbytje. E gjithë uji po derdhet nga lagja Kurrilla dhe kjo pasi që gypi i një kanalizacioni është mbuluar me beton nga një qytetar. Banorët e kësaj lagje janë tejet të shqetësuar. Duhet të merren masat e nevojshme për këtë problem. Në fund ju informoi se para disa dite në lagjen Jeni mahalla një person me sëpatë në dorë ka dëmtuar rëndë një veturë pasi që vetura kishte targat e Serbisë. Personi është arrestuar nga autoritete policor dhe është dërguar në mbajtje mirëpo pas 2 dite ai është liruar. Ky person tani më është i lire dhe po vazhdon të paraqet rrezikshmëri për qytetarët

pasi që ka problem mendore. Këtë ngjarje e ceka vetëm për informatë, sepse siguria e qytetarëve është e rëndësishme për ne.

**Azem Durmişi (NDS):** Koristim priliku da čestitam mjesec Ramazana. I očekujem da ču naiči na razumjevanje. Pošto je ovaj mjesec Ramazana, mjesec tolerisanja. Najpre bi se obratio gradanačelniku direktno, pošto nismo naišli na razumevanje kao građani, na realizaciji određenih projekata gde mještani. Konkretno mještani sela Manastirice već skoro četiri godine čekaju zahtev za realizaciju projekta. U kojem učestvuju 75 svojih finansiskih sredstava. I hteo bi da preduzmu određene korake koje su potrebne da li KEDS ili KEK ko je nadležan, da znamo da je institucija i da realizuje konačno ovaj projekat. Drugo pitanje bi uputio direktoru Bezbendosti i Emergenciju. A koja ovaj naziv Emerdenca samo kao naziv. Ja mislim da bi tako da reagujemo i na određene zahteve. Pa bi hteo da mi se odgovori na zahtev što su uputili meštani Donje Lubinje. Zahtev pod rednim brojem protokola 1132504, i 0028838518. Podnešen zahtev 25 februara 2018 godine. U pitanja je oštećenje puta koje nastale, upoznati smo u to doba od obilnih padavina gde su nastale ne samo povodom ovog zahteve, nego i drugim delovima opštine Prizren. I treba da se preuzimaju potrebni koraci. Direktorij za Javne Službe da se preispita zahteve nekoliko meštana sela Rečana, koji takoše su stradali u to doba njihovi placevi. Zbog neprofesionalnog urađenog kanala za odvod kišnih voda. Gde je kanal usmeren direktno u placeve, dat mu je pogrešan smer. I uz vrlo malo investicija za mislim da se taj probelm reši koji preti i dalje, dakle oštećenja tih placeva. Na relaciji gde se spajaju regionalni putevi Manastirica-Nepregošte. I još jednom bi zamolio sada, ne zahtevam. Da se naši zahtevi usvoje što se tiče obeležavanja regionalnih puteva sa linijom razgraničenja saobraćajnih smerova i postavljanje uličnih prepreka za nesavesne vozače, gde skoro svaka seanca imamo po neki problem koji se dešava. Bar ako ništa drugo pored školskih objekata gde ima najviše dece.

**Sadije Osaj Jakupi (LDK):** Parashtrroi pyetje për Drejtorinë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, se çfarë është duke ndodhur me një numër të banesave brenda në qytet nëpër lagje të ndryshme. Familjet i kanë edhe kontratat si përfitues të tyre, mirëpo nuk i shfrytëzojnë. Në mesin e atyre familjeve ka edhe dëshmorë. Sipas informatave që kemi, banesat nuk po ju jepen me arsyetimin që ende nuk ka filluar ndërtimi i asaj banese. Si, p.sh. në lagjen Jeni mahalla. Pyetja tjetër, sa është e njohur edhe për opinionin Drejtoria për Punë dhe Mirëqenie Sociale. Ka pasur thirrje publike për financimin e OJQ-ve që kryejnë shërbimin në fushat e njëjta. Pyetja ime ishte, a mund të më tregoni sa OJQ kanë përfituar, sa janë refuzuar dhe se a po realizohet ky vendim që është publik. A kanë përfituar të njëjtat OJQ si në të kaluarën, apo ka edhe OJQ tjera.

Kam një problem të qyteteve. I drejtohem të gjithëve. Tek qendra sportive Sezai Surroi, para disa vitesh, ka pas një donacioni, ku janë ndërtuar dy fusha, për tenis, një për futboll, një për basketboll dhe një stazë vrapimi rreth 400 metër. Të gjitha në hapësirë të hapur. Dhe në të njëjtën kohë është bërë ndriçimi publik në atë hapësirë. Mirëpo prej ditës së ndërtimit askush nuk ka vu dorë sidomos në ndriçim. Kështu që qytetarët në mungesë të ndriçimit pas orës 20:00 nuk kanë mundësi ta shfrytëzojnë atë. Propozoj që mirëmbajtja e ndriçimit në këtë park rekreativ të kaloj në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, nëse nuk ka qenë dhe në kuadër të ndriçimit publike. Në mënyrë që në orët e vota të mbrëmjes mos të bëhet çerdhe e narkomanëve. Përpara kam edhe një kërkesë. Më qenë se është edhe në pikën e fundit, mirëpo desha të ju bashkëngjitem, ngase arsimi është fushë e rëndësishme në veçanti për rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve. Në disa komuna ekziston zyrtarë për të drejtat e fëmijëve. Dhe është nevoja që nivel komunal të ndermirën dhe të zhvillohen politika të përshtatshme që do të mbështesin zhvillimin dhe formimin e personalitetit të tyre. Duke i respektuar të drejtat ndërkombëtare të fëmijëve. Legjislacioni ekziston, duke u nisur nga konventa ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve, kushtetuta jonë, ligji mbi familjen. Rrjedhimisht ne si komunë e dytë në Kosovës, kemi nevojë për një zyrtarë për drejtat e fëmijëve, i cili do të inicon politika të përshtatshme komunale, monitorimin dhe zbatimin e tyre.

**Dafina Billaca (PDK):** Në seancën e kaluar kam ngritur çështjen rreth pronave të uzurpuara dhe infrastrukturës përfshi rrugët e qytetit të Prizrenit. Rreth çështjes së pronave të uzurpuara sot më është kthyer një përgjigje ku thotë: Ne si drejtori nuk kemi të dhëna për uzurpimin e tokave pronat publike. Ku ndër të tjera thuhet se ne si drejtori nuk kemi dal në terren për matjen, incizimin e gjendjes faktike. Unë dua të pyes Drejtorin për Gjeodezi dhe Kadastër. I nderuar athua kush duhet të del në terren për të bërë matjen e gjendjes faktike të pronave të uzurpuara. A mos ndoshta prisni që ne të dalim vet dhe ju të mbani orarin e punës sa për sy e faqe dhe sa për të postuar fotografi në rrjetet sociale kinse jeni duke punuar. Nëse doni informata rreth pronave të uzurpuara, unë në lagjen Arbana, kam dy prona ku i di me numër të kadastrit, që janë të uzurpuara dhe ato janë të uzurpuara pikërisht nga militantet e VV-së. Dhe ndoshta kjo është pengesa që juve po ju pengon për atë matjen e gjendjes faktike të këtyre pronave. Sepse nuk doni të ua prishni qejfin atyre që ju kanë dhënë vota. Ndërsa sa i përket çështjes për rrugët në lagjen Arbana, konkretisht në rrugën Likeni i Hasit dhe Beteja e Pashtrikut. Kjo ka qenë një pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike. Ku ndoshta nuk e di Drejtori i Shërbimeve Publike a ka dal me bo gjendjen faktike të këtyre rrugëve apo jo. Apo ndoshta edhe ky vetëm një shkresë sa për sy e faqe me na dhënë. Kisha pas



dëshirë që të del në lagjen Arbana. Ku dihet se lagja Arbana është pjesë e qytetit dhe gjendja e lagjes më keq se në shumë fshatra të Prizrenit. Kërkoj nga Drejtoria e Shërbimeve publike të del dhe ta vizitoj Arbanën dhe ta shoh gjendjen e saj. Të merr masa sa më shpejtë ndaj këtyre rrugëve, sepse qytetarët më të vërtetë janë në kushte shumë të rënda.

**Vjollca Kabashi:** Në seancën e kaluar e kam ngritur çështjen për qendrën e stomatologjisë. Këtë pyetje desha prapë t'ia parashtroj drejtoreshës së Shëndetësisë. Drejtoreshë, a ke qenë ta viziton qendrën e stomatologjisë. Në qoftë se ke qenë, a të ka ardhur keq për gjendjen që është atje. Duke filluar nga dhomat specialistike të fëmijëve e tek dhomat e shoqërisë civile. Mos të flasim po të tregojmë me fakte atje se çfarë është.

**Kryetari i Komunës, Mytaher Haskuka:** Unë së pari ju falënderoj për të gjitha pyetjet që kanë qenë me vend. Për disa pyetje jam duke u befasuar me juve, pasi që keni qenë në pushtet dhe nuk i keni bërë për dhjetë vjet. Më vjen mirë që keni filluar ti shihni këto probleme ku besoi që do ti tejkalojmë të gjitha. Sa i përket pyetjes në lidhje me ujin, nuk kam thënë për tre muaj. Për tre muaj kam thënë ndoshta kemi mi analizuar gjendjen si është dhe çka duhet bërë. Ne, brenda këtyre gjashtë muaj kemi ndarë edhe 200.000 € shtesë për investimet në sistemin e ujit. Në momentin që kjo linja që po vjen nga katërdhjet bunari, në momentin që kryhet kjo, shumë do pjesë të qytetit s'kanë me pas problem me ujë. Ndërsa pjesë tjera të cilat kanë të bëjnë me Zhurin dhe fshatrat tjera, jemi në proces të analizës dhe të planifikimit dhe do të bëhen investime edhe aty. Në anën tjetër kemi bërë marrëveshje me Radoniçin, që një pjesë e Hasit të furnizohet nga... Urdhëro, duhet mi pagua diku rreth 150.000 € për shkak të problemeve që janë edhe mu lidh prej Lubizhdës Hasit deri te Gjonaj edhe mos me pas problem edhe ajo pjesë me ujë. Çështja e policisë, ne nuk kërkojmë prej policisë me siguria as Kuvendin komunal, as administratën e komunës. Po në raste të caktuara, policia kur vlerëson që ka nevojë, ata vinë vetë. Me policinë kemi një marrëveshje që kemi bërë për Inspektorat. Ngase në shumë raste kur inspektorati ka dal edhe është dashtë me punua edhe me bo rrënimin e objektit, policia nuk ka ardhur në momentin e fundit. Pastaj e kemi pa të udhës që me pas një marrëveshje me policinë, ku ne paguajmë 4-5 policë që ata të jenë gjithmonë në gatishmëri kur bënë aksion komuna e Prizrenit. Edhe me njëfarë aspekti një shërbim që s'duhet me pagua. Faktikisht ne i paguajmë taksat tona, ne si komunë po e paguajmë dy herë. Po kjo është gjendja në Kosovë. Si komunë ne s'mundemi me marrë policë edhe me i punësua. Po vetëm mundemi mi pagua policinë e Kosovës, që ata me na ofrua shërbime shtesë. Sa i përket çështjes së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, ai kompleks është me Ministrinë e Kulturës, edhe të gjitha kritikrat mundeni me ia dërgua

Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Sa i përket teleferikut dhe vendimi i OSHP-së, mendoj që ky vendim është skandaloz. Në vendim kërkohet që ne me rivlerësuar diçka që si projekt nuk i plotëson kriteret. Do më thënë OSHP-ja po kërkon prej neve që ne me shkel ligjin. Unë e kam prur edhe vendimin e anulimit, se ky projekt nuk bënë me vazhdua. Edhe nëse tash folim me një anë themi se mbrojmë qendrën historike të Prizrenit edhe në anën tjetër po kërkojmë që mu zbatua një projekt i cili është në kundërshtim me Ligjin për Trashëgimi Kulturore, edhe në kundërshtim me Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit po edhe ligjin për ujërat. Atëherë kjo nuk është në rregull. Ose je për me mbrojt qendrën historike të Prizrenit, ose nuk je për me mbrojt qendrën historike të Prizrenit. Përndryshe OSHP-ja ka shikuar aspektin procedural dhe po thotë me rivlerësuar. Ne do të shikojmë mënyrat se si duhet me e ndal këtë projekt, sepse është një projekt i cili nuk bënë me u bo. Nëse revidohet projekti tërësisht atëherë ndoshta bënë. Po ashtu qysh është projekti nuk bënë. Më mirë në atë aspekt do ta qoj deri në fund çështjen. Nuk kam frik prej këtyre organeve të cilat janë të kapura, vendosin kundër interesit të qytetarëve edhe kundër ligjshëm është faktikisht. Pikërisht ju që thatë për pishinën. Ne kemi gjet atë, është dashtë me vazhdua. Nëse s'kishim me vazhdua, kishim me ra në aspektin e ligjor në konflikt dhe është dashtë me pagua për kontratë pa bërë punë. Në disa aspekte kur e ke kontratën faktikisht edhe s'ke çka me bo, komuna duhet me vazhdua. Tek teleferiku kontrata nuk ka qenë e dhënë. Kanë qenë vetëm ofertat edhe ne nuk kemi vazhdua me rivlerësim të ofertave, kjo ka qenë çështja. Po do të shikojmë edhe këtu si do të tejkalojmë. Është çështja e shtëpisë së kulturës në Zhur. Si thatë edhe ju një ndër pikat kyçe ka qenë që me e vlerësuar gjendjen. Janë mënyra të ndryshme se si mund ta bëjmë këtë. Ne jemi të mendimit që me bo me Universitetin e Prishtinës, me departamentin e ndërtimitarisë edhe me inxhinierët nga universiteti i Prishtinës, që ata me analizua këtë edhe me qenë me një çmim më të ulët kjo analiza. Para se me vazhdua punimet aty. Varësisht prej vlerësimit që kanë me bo ata. Do të shikojmë se ku duhet me bo investime në shtëpinë e kulturës dhe si duhet me u rregullua gjendja aty në aspektin statik. Se problemet janë lidhur me statikën e dështimit. Sa i përket ueb sajtit të komunës, unë nuk i kontrolloi. Mirëpo në momentin që e kemi marr komunën, ueb sajt i nuk ka qenë funksional. Është brenda Ministrisë së Administratës Publike që mbahen serverët, që është i dizajnuar ueb sajt i ri. Neve na kanë kritikua deri në prill shoqëria civile për mosfunksionim. Edhe pse ne kemi ngritë disa herë çështjen te Ministria për mos funksionim të ueb sajtit komunal. Edhe ai ueb sajt komunal kur ka fillua me punua ka fillua me ato informata që kanë qenë aty. Ne s'mundemi me shkua mbrapa edhe me shikua. Edhe s'kemi mundësi mi shikua ueb sajtet e vjetra edhe mi gjet ato shënime. Po nëse nuk ka shënime për punën e me përparshme të komunës, janë për shkak të Ministrisë së

Administratës Publike. Faktikisht për shkak të do projekteve të cilat janë bërë. Është pranua si p.sh. fatura e 73.000 € për arkiva elektronike. Po arkiva elektronike në komunë nuk ekziston. Kjo është bërë prej qeverisjes së kaluar. Do më thënë qeverisja e kaluar i ka dhënë 73.000 € për arkivin elektronik e cila nuk ekziston. Ne s'mundemi mi shpik këto dokumente. Të kishim pas arkivin elektronik, ti kishim pas të gjitha këto të arkivuara në mënyrë elektronike, kishte me qenë shumë lehtë për neve mi qit në ueb sajt edhe nuk kishim me pas kurrfarë problemi. Ka edhe sende tjera të cilat janë pak që s'janë bo. Po ato i kemi dorëzuar në prokurori z. Baldedaj. Do më thënë këto janë pikërisht prej Administratës Publike të cilat janë pagua. Nuk ekziston, janë dorëzua, vetëm dy skener i kemi dorëzua. Tek Benafi, e kemi nënshkruar marrëveshjen për implementimin e shkollës së Muzikës dhe është në proces të tenderimit. Ky është investimi i Ministrisë dhe Ministria nuk e di kur i fillon punimet aty. Po ne qysh kemi shikua gjendjen aty është në rregull. E kanë bërë edhe një qendër folklorike edhe do të jenë aty dy ndërtesa. Për publikimet në gjuhë të ndryshme. Po kemi problem pak me përkthime. Si thamë gjithë ueb faqen duhet ta kemi në tre gjuhë, po ashtu edhe publikimet e shpalljes. Do të shikojmë se si do të tejkalojmë këtë problem ngase kemi shumë dokumente që janë duke u përkthye. Prej rregulloreve të ndryshme që i kemi sot të cilat do të votohen ndoshta edhe deri tek punët tjera të cilat po bëhen. Atë që nuk po e vëreni ajo është problem tjetër. Sa i përket pronave të uzurpuara të gjitha ato të cilat janë të komunës dhe janë uzurpuar do ti kthejmë mbrapa. Na duhet një kohë me konstatua gjendjen. Nuk kemi shënimet për pronat e komunës të cilat i ka komuna e Prizrenit. Kemi me krijuar listën e cila do të jetë publike. Edhe për pronat në aspektin e tokave por edhe në aspektin e ndërtesave të cilat i ka komuna. Edhe të cilat janë të uzurpuara dhe të gjitha do ti kthehen komunës. Pa marrë parasysh se kush i ka uzurpuar ato.

**Fejz Kabashi, drejtor i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale:** Pyetja e parë nga Karanfili ishte, deri ku arrit faza për materialin ndërtimor. Për fillim ju njoftoj që këtë vit nuk do të jepet material ndërtimor. Po është ndryshimi drastik nga ai projekti i kaluar, do të ndërtohen shtëpi. Drejtoria ka pranua deri në atë afatin që kishim në thirrjen publike deri më 30 prill, rreth 300 lëndë. Komisioni është informua nga kryetari i komunës në ueb faqe. Çdo vendim i kryetarit unë po e vërej në ueb faqe, një përgjigje edhe për ty kjo vlen. Nuk e di ti pse se kuptua atë të OJQ-ve. Është vendimi për çdo komision në ueb faqe. Edhe komisioni për materialin ndërtimor është duke u bërë verifikimin e aplikuesve në adresat e tyre. Të gjitha rajonet e Prizrenit kanë përfunduar edhe gjysma e lagjeve. Po shpresojmë që për një periudhë shumë të shkurtë, ndoshta dhjetë ditë dy javë do të përfundoj verifikimi i të gjitha lëndëve. Pastaj bëhet

poentomi i tyre në bazë të kriterëve që janë të caktuara me ligj. Dhe është një listë nga udhëzimi administrativ i ligjit për banim të veçantë, që na cakton saktë edhe sa poenë secili qytetarë i merr. Ata që kanë aplikua për çështje të banimit. Kur ta arrimë te ajo fazë prapë ju njoftoj dhe shkojmë në atë përgjigjen definitive se kush fiton. Deri më tani jemi ende në verifikim. Sa për informatë do të fitojnë 50 qytetarë. 20 prej tyre bashkëpunimi me Jetimat e Ballkanit do të ndërtohen me çelësa në dorë. Kurse ne 100.000 €, do ti japim nga 5.000 € material atyre. Ndërsa pjesa tjetër 200.000 € nga 300.000 € sa janë paraparë në këtë projekt do të jepen për 20 shtëpi kulm mbi kokë dhe për 10 tjera vetëm kulm, që kanë konkurruar qytetarët vetëm për kulme. Ndryshimi është se do të ndërtohen shtëpi. Kalojmë te pyetja që bëri Sherifja po i përgjigjet edhe Sadijes. Së pari Drejtorja ka pas thirrjen publike që është nëpër të gjitha portalet mediat, ueb faqen e komunës. Për me aplikua OJQ-të që ofrojnë shërbime për qytetarët me nevoja të veçanta i përket lëmisë tonë. Për këtë çështje është formuar komisioni i cili prapë është publik edhe është në ueb faqen e komunës. Në të njëjtën formë komisioni ka shkua i ka verifikuar në vendngjarje secilën OJQ, dhe ka marrë anamnezën për secilën OJQ se çka ofron dhe cilët shërbime i ofron. Nëse ti Sherife ke me ndonjë OJQ po mendoj simpati ose diçka. Mundesh me përmend emrin, edhe unë me tu përgjigj bash për atë OJQ. Komisioni ka vendos nga 13 që kanë aplikua, 11 prej tyre jua ka realizua edhe e ka bo këtë ndarje. Duke filluar prej 4.500-500. Dy i ka refuzua, jo që s'kanë meritua, por njëra është Nënë Tereza. Edhe jemi dakordua me ta. Ka pas projektin e njëjtë sikur tonin që kemi shpërnda pako ushqimore të njëjtin projekt. Ne e kemi pas pothuaj edhe fazën përmbyllëse për atë projekt. Prandaj s'kishte logjikë ne me ia dhënë atyre se vet ishim duke e zbatua. Edhe një organizatë e rinisë që ka marrë një shumë të konsiderueshme të kulturave. Me ata jemi dakordua, janë duke u marrë me atë projekt dhe projekti ynë nuk shkon konform kërkesave tona. Kështu janë financua. Komisioni ndoshta që duhet me i përmend emrat i përmendi janë publik, po s'po e shohë të arsyeshme edhe me ti përmend. Është vërtet që për herë të parë përmes zyrës së prokurimit fitojnë 50 familje. Hera e parë përmes zyrës së prokurimit. Është tërësisht e vërtetë edhe plotësisht qëndroj, që për herë të parë përmes zyrës së prokurimit i kemi dhënë 70 familjeve që i ka ofruar Qendra Sociale. Ndërsa që i përmend kjo me Jetimet e Ballkanit. Unë i kam 600 me Jetimet e Ballkanit. 200 i ka dhënë në fillim të Ramazanit dhe 400 do ti jep në fund të Ramazanit. Kurse atë që e ka përmend për kuzhinën popullore. Këta i kanë dhënë 50 unë 60. Të familjet e dëshmorëve këta i kanë dhënë 60 unë 65 do ti jap në shtator. Pyetja e Sadijes që është shumë me vend, nuk jam i përgatitur shumë për këtë pyetje. Po kam katër lëndë vetëm. Do më thënë në bazë të atyre katër lëndëve mundëm më siguri me tu përgjigj. Është çështje shumë e ndjeshme për ata qytetarë. Janë rreth 15

qytetarë që kanë fitua aty banesa nga 2014 dhe si gëzojnë ato banesa. Unë i kam katër lëndë. Kanë thënë mos bëjnë njëherë me emra publik. Punë kryesuese ju thotë se banesa ende s'është ndërtuar për ju. Këtu shkruan lamela numri, edhe e kam vërtetua se ajo banesë është e ndërtuar. E kam ftuar mbi dy, tri herë menaxherin të ajo lagja sidomos, nuk ka ardhur në zyre. Jam duke e përgatit me gjet formën se si do ti detyrohet ai komunës.

**Haziz Hodaj (LDK):** E kam një kërkesë pikërisht në lidhje me përgjigjet. Këtu bëhen kërkesa edhe pyetje prej anëtarëve të Kuvendit, që duhen statistika. Kërkoj që drejtorët me qenë në mbledhje ose asistentët apo koordinatorët të jenë prezentë. Përgjigjet të jepen me shkrim në seancën e radhës. Mos na maltretoni tash edhe me pyetje edhe me përgjigje. Dyfish po përsëritet.

**Kryesuesi:** Me Statut të Komunës së Prizrenit, drejtorit i takon mu përgjigj në seancë drejtpërdrejtë nëse ka përgjigjen aty për aty, ose ti kthej pas 30 dite përgjigjet me shkrim. Nuk jeni të obliguar mi dhënë përgjigjet, përpos vetëm nëse e shiheni të arsyeshme në Kuvend. Përndryshe përgjigjet tjera vijnë me shkrim në seancën e radhës.

**Skender Susuri, drejtor i Drejtorisë për Arsim:** Unë do të ndërlihdhëm me pyetjen që e bëri profesor Kastrati, sa i përket korrektesisë së drejtorëve në dhënien e përgjigjeve. Në cilësinë e drejtorit i kam marrë nëntë pyetje, i kam dhënë nëntë përgjigje me shkrim. Do të vazhdoj të jem i tillë deri sa jam drejtor sepse respektoj institucionin e Kuvendit. Pyetjet e tjera që i kam marrë sot do të merrni përgjigje me shkrim. Jo që nuk i kam përgjigjet këtu, por për hir të kursimit të kohës. Edhe për hir të seriozitetit të çështjes në shkollën e Mjekësisë e cila aktualisht mbizotëron, do të fokusohem vetëm në këtë pyetje. Ndërsa përgjigjet tjera duke përfshirë edhe një raport preciz dhe konciz do të përfshi edhe gjithë procesin e publikimit të konkursit, intervistimit të kandidatëve për drejtorë shkolle dhe listat, mënyrën e poentimit do ta merrni në seancën e radhës e cila më siguri do të mbahet në fund të muajit qershor. Unë kisha kërkuar nga kryesuesi, mundësisht në atë udhëzim që e ka kërkuar kryetari dhe e ka përgatit drejtoria komunale. Kemi kërkuar që të jenë edhe dy përfaqësues të Kuvendit komunal. Kjo për fajin tim ashtu nuk kanë ndodh dy intervistimet e para për mungesë kohe. Intervistimi i radhës fillon ditën e hënë, të martën. Ka një ndërprerje për një interesim të kryetarit. Sepse kemi në tre shkolla të komuniteteve. Tre kandidat të njëjtë kanë konkurruar në tre shkolla. Dhe kryetari e ka parashtruar një pyetje tek unë, që unë nuk kam pas përgjigje. Çka ndodh nëse një kandidat fiton mbesin dy. A procedohet më tej konkursi, unë kam pas përgjigje. Ju kam adresua me shkrim departamentit ligjor të MASHT-it. Me shpresën se e marrim përgjigjen për ditën e hënë e kemi caktuar

vazhdimin e këtyre proceseve intervistuese. Sa i përket çështjes së shkollës së Mjekësisë vërtetë është një situatë shumë e rënduar shumë shqetësuese. Unë jam munduar që edhe në media të prononcohem për atë që kam autoritet dhe për atë që nuk ndikoj në çështje. Ne bashkë me kryetarin kemi qenë disa herë në shkollën e mjekësisë. Personalisht kam marrë pjesë edhe në këshillin e arsimitareve me prindërit e klasës përkatëse. Edhe dje e kam takuar edhe këshillin drejtues të shkollës. Situata ka qenë tepër e rënduar me i humbë ty fëmijë, përkatësisht dy vajza të reja. Dhe klasën X-4 jemi shtrëngua në pajtim me prindërit tre ditë përpara me ndërprerë procesin mësimor. Nga që kanë qenë të shqetësuar, nuk po them më trauma. Dhe dje kemi bashkëbisedua me kryetarin edhe me ministrin e Arsimit. Kemi dashtë që për dy ditë të mbetura të mësimin, ta ndërpresim mësimin edhe në shkollën e mjekësisë komplet. Mirëpo, pastaj me bashkëbisedimin shërbimit policor të Kosovës. Në veçanti me Drejtorinë e përgjithshme të policisë janë shtua masat e sigurisë në atë shkollë. Dhe ka qenë dakordancë e atyre që ne garantojmë siguri të plotë. Kështu që unë sot ua jap një informatë që procesi mësimor edukativ në këtë shkollë, është duke u zhvilluar normalisht. Dhe fal Zotit për momentin edhe sigurisë që është bo. Sigurisht edhe angazhimit të Drejtorisë edhe stafit që punon aty. Aktualisht procesi është duke u zhvilluar normalisht. Siguria në përgjithësi në shkollat tona. Ne të gjithë pajtohemi që nuk ka qenë në nivele të mira. Kjo për shumë arsye. Masat e Drejtorisë komunale cilat do të jenë. Sigurisht do të jenë masa që do të diskutohen në këtë Kuvend bashkërisht me ju. Dhe të shohim çfarë duhet të bëjmë si Drejtori komunale dhe si komunë. Që siguria në shkollat tona të jetë më e mirë. Unë personalisht jam ihtarë dhe kam bisedua me Drejtorinë e përgjithshme policore që nga 1 shtatori, forcat policore të jenë prezent, jo brenda oborreve shkollore. Po të jenë prezent në hyrje të shkollave. Po kjo do të jetë çështje që do të diskutohet me policinë me kryetarin e komunës, sigurisht edhe me ju kuvendarët. Ne kemi thënë që asnjë vendimmarrje të madhe nuk do ta bëjmë jashtë këtij Kuvendi.. Sigurisht do të jenë edhe psikolog, kryetari vetë e ka thënë në prononcim publik. Në shumicën e madhe të shkollave, në veçanti në shkollat e mesme, do të jenë shërbimet psikologjike sociale. Mirëpo, këto masa sigurisht duhet të shoqërohen edhe me punë më të mirë, që ne duhet me bo në sistemin arsimor. Duke filluar nga Drejtoria komunale, drejtoret e shkollave, mësuesit dhe mbështetja që duhet me na dhënë prindërit. Sepse pa funksionimin e këtij trekëndëshi, arsimtar, shkollë, prind për siguri. Siguria përsëri nuk do të jetë në nivele të dëshirueshme. Por edhe njëherë po ju garantoj, ne në qershor do ta adresojmë një rregullore këtu. E cila do të trajtoj çështjen e adresimit të dhunës në institucionin arsimor. Edhe së bashku do të marrim vendime, cilat do të jenë veprimet konkrete, që ne nga 1 shtatori duhet të ndërmarrim shkollat tona. Që

dash të Zoti gjëra të tilla kurrë mos të na ndodh. Unë edhe njëherë po shprehi publikisht nga kjo foltore ngushëllimin më të thellë për familjet, për shkollën dhe për të gjithë qytetarët e Prizrenit, për rastin tragjik. Të gjitha pyetjet e kuvendarëve, të profesor Fatmiri, të jesh i sigurt që unë i kam adresua me shkrim, do të vazhdo me i adresua me shkrim. Në veçanti do të kem shumë kujdes, që komplet raportin në seancën e qershorit për procedurat e drejtorëve do ta bëjë publik dhe transparent.

**Fatmir Memaj, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm:** Lidhur me pyetjet që u parashtruan nga asamblisti Karanfil Haxhillari dhe znj. Mimoza Bushrani. Unë mund t'ju them, se një dispozitë ligjore për të cilën ju jeni të interesuar, lidhur me distancën e ndërtimeve të objekteve përgjatë lumenjve. Nuk është distancë 30 metra, siç e ceku z. Karanfil, po është distancë prej 10 metrave. 30 metra është e caktuar një distancë tjetër për disa çështje tjera, do më thënë ku janë akumulimet e ujërave. Edhe për këtë punë nëse nuk bindeni, ose keni paqartësi tjera. Ne mund të kërkojmë edhe interpretim ligjor prej Ministrisë adekuate. Distanca prej 30 metrave nuk ka mundësi me ekzistua në këtë rast, se ndoshta në këtë rast edhe Xhamisë së Sinan Pashës i bije me u rrënuar në këtë distancë prej 30 metrave, edhe shumë objekteve tjera.

**Ilir Baldedaj:** Përderisa ai merret me çështje koti si kryetar komune edhe thirret në emër të ligjit. Ai ka bërë shkelje ligjore edhe me nënshkrimin për marrëveshjen e shkollës së Muzikës. Sepse ky Kuvend ka marrë njëherë vendim për atë lokacion dhe Ministria e Pushtetit Lokal e ka kthye, se është në kundërshtim me planin rregullativ. Nëse ai flet, unë e ftoj zyrën e prokurimit ta bëjë publike çështjen e arkivës elektronike. Çka kërkohet në atë kontratë dhe është e paraparë gjithçka sipas kontratës që është e nënshkruar nga zyra e prokurimit. Sepse është ka e gënjen qytetarin. Sepse nga mosdija për tu përgjigjur për tu ballafaquar me problemet, ai e ka gjet si mjet akuzues. Ndërsa sa i përket prokurorisë, sot këtë dosje, unë do ta dërgoj në prokurori që është shkelje ligjore e kryetarit të komunës me rastin e teleferikut. E mos të na shet mend, se gjashtë muaj si ka qeverisje i ka me mijëra shkelje.

**Kryesuesi:** Kërkoj nga drejtorët që të gjitha pyetjet që sot nuk u dhanë në seancë, ti përgatisin në seancën e ardhshme me shkrim. Këtu ka një arsye sepse ekzekutivi qëndron para Kuvendit. Dhe pikërisht është kjo puna e kthimit të përgjigjeve në çështje që ngritën në Kuvend. Ju kisha lutur që ti merreni seriozisht dhe të gjitha pyetjet e anëtarëve të Kuvendit të kenë përgjigje, për seancën e ardhshme.

**Pika e katërt:**

**Shqyrtimi dhe miratimi i propozimvendimit për Binjakëzimin e Komunës së Prizrenit, me Bashkinë e Beratit, të Republikës së Shqipërisë**

Në materialet të cilat i keni marrë, aty e gjeni një propozim që i drejtohet Kuvendit. Kompetencë e së cilës është votimi dhe marrja e vendimit për lidhjet ndër komunale, ndërkombëtare që na jep ligji si kompetencë si qeverisje lokale. Siç e dini komuna e Prizrenit dhe Bashkia e Beratit së fundmi kanë nënshkruar një marrëveshje të vullnetit të mirë. E cila marrëveshje ka për synim ndërtimin e një marrëdhënie reciproke me qëllim të shkëmbimit të përvojave, ekspertizave në lëmit e kulturës dhe sferat e ndryshme që lidhen me vetëqeverisjen lokale dhe interesit reciprok. Prizreni ka shumëçka çka merr shembull tek Bashkia e Beratit, pse jo edhe Bashkia e Beratit, në çështje ku mund të merr shembull nga komuna e Prizrenit. Ky është një trinom i binjakëzimit ta quaj kështu. Ku në të përfshihet edhe komuna e Amasyas Republika e Turqisë. Pra është një bashkëpunim ndërmjet tri komunave e cila ka rezultuar edhe me iniciativën e lidhjes binjakëzimit në mes të komunës së Prizrenit dhe Bashkësisë së Beratit. Nëse nuk jam i gabuar Bashkia e Beratit do të jetë Bashkia e parë, apo komuna e parë me të cilën komuna e Prizrenit ka marrëveshje binjakëzimi me ndonjë komunë të Republikës së Shqipërisë, nuk jam i sigurt. Po nëse s'gaboj kështu u informova. Sido që të jetë, besoj që e keni lexua materialin dhe tani kërkoj nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare që ta marrin fjalën për këtë pikë të rendit të ditës.

**Dafina Bllaca:** Kërkoj të di arsyen se përse sipas jush është komuna e parë që është binjakëzimi, që po e quani ju kryesues. Arsyen ta jap unë, sepse ne jemi vëllezër me Shqipërinë, nëse e njehni historinë, kryetari më shumë. Po s'ka faj ai se nuk e njeh fort. Ne jemi vëllezër den baba den. S'kemi pas ne me bo binjakëzim fare. Ne mundemi të bëjmë marrëveshje ose me i shkëmbye përvojat e njëri tjetrit, e jo binjakëzim. S'po më duket diçka që vlen kjo. Mirëpo nuk jemi kundër kësaj. Ne patjetër do ta mbështesim. Mirëpo forma se si e keni marrë, është komuna e parë si lavd, mua nuk po më duket lavd.

**Kryesuesi:** Po mund të merret edhe si kritikë. Sepse është dashur deri tash të kemi ndonjë binjakëzim një me ndonjë nga komunat e bashkësisë...

**Bllaca:** Marrëveshje mundemi me pas, mirëpo jo binjakëzim.

**Kryesuesi:** Sido që të jetë, edhe njëherë deklaroheni për pikën e rendit të ditës. Jeni për apo.

**Karanfil Haxhillari:** LVV-je e mbështet këtë dhe jemi pro binjakëzimit.



**Sadije Osaj:** Edhe nga LDK-ja jemi pro.

**Kryesuesi:** Ju lutëm mos të lëshohemi në çështje banale. Po flasim për dy republika të njohura ndërkombëtarësh dhe çështja e binjakëzimit është një procedurë juridike, që e ndjekin të gjitha vendet. Përndryshe po kalojmë në çështje politike. Le të futen në programet e juaja ideja e bashkimit kombëtarë. Atëherë thirrëmi në çështjet den baba den. Deri atëherë të deklarohe mi lidhur me këtë iniciativë.

**Fatmir Kastrati:** Jemi për. Po nuk është banale kryesues. Po nxisim debate. Është mendimi i jonë, secili ka të drejtë ta thotë. Jemi për binjakëzimi patjetër, ka dobi prej njëri tjetrit. Prandaj është një mendim i jemi që e dhashë edhe i parafolësit. Prandaj nuk ka kurrjë banale.

Nisma ...?: Pra edhe Nisma Socialdemokrate është për binjakëzimin Prizrenit me Beratin.

**Cenet Sayhadi:** Geçen yll Prizren Belediyesi ile Amasya Belediyesi arasında yapılan kardeş belediye anlaşmasınının şehrimiz için yararlı olduğunu düşünüyorum, bu yüzden Kosova Demokratik Türk Partisi adına Prizren Belediyesi ile Berat Belediyesinin kardeş belediye anlaşmasını onaylıyoruz.

Binjakëzimi i Komunës së Prizrenit me Komunën Amasya në vitin e kaluar mendoja se është e dobishme për qytetin tonë andaj në emër të Partisë Demokratike Turke të Kosovës pranojmë marrëveshjen e binjakëzimit të Komunës së Prizrenit me Komunën e Berat- it.

Vakat: Podržava.

**Azem Durmiši:** Takođe i NDS podržava predlog na pobratimljenje opština Prizren i Berat.

**Kryesuesi:** Atëherë 30 anëtarë të Kuvendit janë në sallë, e hedhim në votim propozimvendimin për Binjakëzimin e Komunës së Prizrenit, me Bashkinë e Beratit, të Republikës së Shqipërisë, kush është për?

Për? – Të gjithë.

Kundër? – S'ka.

Abstenim? – S'ka.

Atëherë konstatoj se unanimisht aprovohet propozimvendimi për Binjakëzimin e Komunës së Prizrenit, me Bashkinë e Beratit, të Republikës së Shqipërisë. Dhe le të vazhdojnë procedurat për konkretizimin e këtij binjakëzimi.

## **Pika e pestë:**

### **Informatë mbi Planin e punës së Prokurimit për vitin 2018**

Në kuadër të planit të punës së Kuvendit që e kemi bërë i kemi paraparë disa pika të rendit të ditës nga muaji në muaj. Me qëllim të informimit të anëtarëve të Kuvendit lidhur me punën e ekzekutivit, me sektorët e sajë të ndryshëm. Të cilat konsiderojmë se janë çështje edhe në interes të anëtarëve të Kuvendit edhe të vetë Kuvendit, po edhe të interesit publik. Prandaj ftoj përfaqësuesin e zyrës së prokurimit z. Isa Osmankaj të na jap një informatë lidhur me atë se si shkon plani i punës për vitin 2018.

**Isa Osmankaj:** Zyra e Prokurimit për çdo vit fiskal paraprakisht bënë plane të prokurimit, i cili më pastaj implementohet gjatë vitit vijues. Plani i prokurimit është përpilua në vitin 2017. Është hartua pikërisht nga ky institucion, nga asambleja komunale. Më pastaj i është nënshtruar edhe votimit në Parlamentin e Kosovës. Dhe si ligj për buxhet ka hy në legjislaturën e Kuvendit të Kosovës, njëherit është shpërndarë edhe për autoritetet kontraktuese që ne i quajmë në mbarë Republikën e Kosovës. Plani i prokurimit për komunën e Prizrenit, është përpilua kryesisht në tri kategori. Do më thënë i ka tri shtylla të cilat e bëjnë këtë plan. Ato janë kategoria e furnizimeve, kategoria e punëve dhe kategoria e shërbimeve. Ka edhe kategori tjera, të cilat e përbëjnë planin e prokurimit. Por konkretisht për komunën e Prizrenit janë këto tri shtylla që janë pjesë përbërëse e këtij planifikimi. Po i përmend disa çështje teknike të cilat e përbëjnë këtë plan, p.sh nga kategoria e furnizimeve kemi gjithsejtë 33 projekte. Projektet e përfshira në këtë plan janë projekte që tejkalojnë 1.000 € dhe shkojnë deri në infinit. Do të thotë pjesa e epërme nuk është e kufizuar. Pastaj shërbimet janë 38 projekte dhe për punë janë 178 projekte. Vlera e përgjithshme e këtij planifikimi për vitin 2018 është 17.385.671 €. Ndërsa ndarë në këto tri kategori që i përmenda janë si vijon: Për punë vlera e përgjithshme punimeve të parapara të realizohen për vitin 2018, sipas këtij planifikimi është 14.100.241 €. Për shërbime është 1.491.802 €. Edhe për furnizime 1.793.628 €. Ju thash fillimisht se ky planifikim hartohet, përpilohet, ideator, kreator është asambleja komunale, janë asamblastët. Ku përfshihen të gjitha projektet që ata i propozojnë në bashkëpunim me drejtoritë përkatëse të stafit. Ndryshimet në këtë planë të prokurimit mund të bëhen vetëm më rishikim të buxhetit, i cili është pas muajit qershor. Gjithashtu votohet prej asamblesë komunale dhe më pastaj miratimin final e merr prej Kuvendit të Kosovës. Si përmbajtje të këtij planifikimi janë këto kategori që i përmenda. Mirëpo, ato projekte si më të rëndësishme ose me vlerë të madhe, janë në kategorinë e furnizimeve. Kemi projektin për furnizim material ndërtimor e përmendi drejtori, që tash e paskan

shndërrua në ndërtim shtëpive të banimit për raste sociale. Vlera e këtij projekti është 300.000 €. Pastaj kemi një projekt të Drejtorisë së Shëndetësisë, është blerja e një aparati të rëntgenit digjital, vlera e të cilit është 160.000 €. Dhe edhe plot projekte të tjera të cilat janë të propozuar nga ana e juaj dhe janë fut në planifikim të prokurimit për vitin 2018. Në kategorinë e shërbimeve është projekti për realizimin e politikave zhvillimore për komunën e Prizrenit, që ka të bëjë kryekëput me kulturën, sportin dhe aktivitetet e rinisë. Dhe i cili e kap një vlerë bukur të madhe është vlera 380.000 €. Gjithashtu është planifikua të realizohet në vitin 2018. Të kategoria e punëve, pastaj keni plot e përplot projekte. Ndër to ndoshta kisha me veçua projektin ndërtimi i infrastrukturës te parku i biznesit. Është viti i fundit, po shpresojmë që këtë vit parku i biznesit do të kompletohet me infrastrukturë. Dhe më pastaj do ti jepen në shfrytëzim qytetarëve ashtu siç është e paraparë me ligj dhe me rregullore që ju i keni miratua. Dhe një projekt tjetër është ndërtimi i llamellës së katërt për banim social. E paraparë 414.000 € dhe e cila do të ndërtohet në lokacionin që do të përcaktohet nga ana e juaj. Këto janë disa prej projekteve në pika të shkurtra. Të gjitha këto janë të publikuara edhe në buxhetin e Kuvendit të Kosovës për vitin 2018. Ligji për buxhet ashtu quhet. Dhe ndryshimet në këtë planifikim mund të bëhen vetëm me rishikim të buxhetit, i cili bëhet nga e juaj dhe miratohet prej Kuvendit të Kosovës

### **Pika e gjashtë:**

#### **Informatë mbi Planin e punës së Auditorit të Brendshëm, për vitin 2018**

**Kryesuesi:** Ftoj përfaqësuesin e Zyrës së Auditorit të Brendshëm që të na bëjë një prezantim të shkurtër të planit të punës, i cili është miratuar në mandatin e kaluar. Por se e pamë të arsyeshme që të jepet si një informatë lidhur me aktivitetet e tyre sa i përket vitit 2018.

**Agron Hoxha:** Ashtu siç e theksoj edhe kryesuesi Plani i Auditimit të Brendshëm është miratuar sipas legjisllacionit në vitin e kaluar. Pra sipas ligjit të auditimit të brendshëm deri 31 tetor të çdo viti, duhet të propozohet së bashku me kryetarin e komunës. Dhe pas miratimit nga ana e kryetarit të komunës ky plan të dërgohet në njësinë qendrore harmonizuese e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Financave. Ne, përpos raportimit që e bëjmë në mënyrë direkte tek kryetari i komunës dhe komiteti i auditimit. Linjën e komunikimit e kemi edhe me Ministrinë e Financave. Dhe prandaj afatet ligjore janë të caktuara sipas udhëzimeve të cilat i kanë përcaktuar ata. Në vitin 2018, sipas planit i cili është propozuar nga kryetari i komunës dhe bashkërisht është diskutua, janë paraparë që të realizohet tetë auditime. Me stafin të cilën e ka pas në kompetencë në atëkohë zyra e njësisë të auditimit të brendshëm. Pra në atë kohë

ne kemi funksionuar me dy anëtar të stafit dhe ky plan është planifikuar që të realizohet sipas numrit të stafit. Nga tetë auditimet të cilat janë paraparë. Janë paraparë pesë auditime me rrezik të lartë. Janë paraparë dy auditime me rrezik të mesëm. Dhe një auditim me rrezik të ulët. Përcaktimi i prioriteteve sipas rrezikut janë sipas metodologjisë së auditimit dhe të gjitha këto janë procedurat standarde, të cilat ne vetëm i aplikojmë dhe i përcaktojmë rreziqet. Aktualisht zyra e auditimit të brendshëm funksionon vetëm me një anëtarë të stafit, për shkak që njëri nga anëtarët e stafit është emëruar drejtor politik. Dhe ne me kapacitetet të cilat i kemi, kemi filluar këtë vit me aplikimin e planit të cilin ju veç e keni parasysh. Deri më tani plani i cili është aktual, ne kemi realizuar tri auditime. Auditimi i parë ka pas të bëjë me pagesat e mëditjeve, menaxhimi i pasurisë dhe tani po sa e kemi përfunduar edhe auditimin për tatimin në pronë. I cili i është dorëzuar kryetarit të komunës. Edhe pse kemi mungesë të kapaciteteve në staf, në bazë të planit aktual jemi duke u munduar të arrimë atë që është planifikuar. Një çështje e cila duhet të theksohet dhe është më rëndësi. Shpesh herë është bërë pyetje edhe nga shoqëritë civile, por edhe nga të interesuarit. Se a kemi të drejtë ne të bëjmë ndryshimin e planit. Ligji e ka paraparë se ndryshimi i planit mund të bëhet vetëm me anë të rekomandimit nga ana e kryetarit të komunës. Pra i vetmi organ është që mund të ndryshoj planin e punës është kryetari i komunës. Por normalisht që propozimet, te kryetari i komunës mund të vinë nga, qoftë Kuvendit, qoftë shoqëria civile. Mirëpo, kompetent kryesor për ta rishikuar këtë plan, sipas ligjeve në fuqi është kryetari i komunës. Pa dashtë me hy në detaje për secilin auditim të cilin ju veç e keni planin e punës. Unë mendoj që kaq ishte, nëse ka diçka ne jemi këtu edhe për anëtarët e Kuvendit por edhe për kryesuesin.

**Kryesuesi:** A ka dikush të shtoj diçka sa i përket këtij prezantimi të shkurtër të planit të veprimit të Auditorit të Brendshëm. Atëherë e falënderojmë përfaqësuesin e Auditorit të Brendshëm për njoftimin e Kuvendit.

#### **Pika e shtatë:**

**Shqyrtimin e raportit financiar të realizimit të Buxhetit Komunal, për tremujorin e parë të vitit 2018.**

Për këtë pikë të rendit të ditës, ftojme drejtorin e Financave Ertan Simitçi që ta prezantoj raportin para Kuvendit.

**Ertan Simitçi, drejtor i Financave:** Komuna e Prizrenit sipas raporteve të Drejtorisë së Financave në periudhën janar-mars për vitin 2018, ka realizuar një buxhet rreth 20% sipas planifikimit. Buxheti i komunës së Prizrenit për vitin

2018, është rreth 45.200.000 €. Ndërsa për periudhën janar-mars 2018, është alokuar rreth 18.600.000 €. Deri në fund të muajit mars është shpenzuar një shumë prej 9.100.000 €, ose 20% të planifikimit. Siç e dimë të gjithë, të gjitha komunat kanë dy burime apo grande kryesore. Grandi Qeveritar është alokuar në shumë prej 17.700.000 €. Ndërsa janë shpenzuar rreth 8.700.000 €, ose 25% të shumës së planifikuar për Grandin Qeveritarë. Në të hyra vetjake të komunës gjatë periudhës janar-mars janë alokuar në shumë prej 778.834 €, ose 10% sipas planifikimit. Dhe nga kjo shumë janë shpenzuar rreth 452.465 €, ose 6% të shumës së planifikuar. Nga burimet tjera deri në këtë periudhë nuk kemi pas ndonjë shpenzim. Të hyrat vetjake të komunës së Prizrenit planifikimi është rreth 8.106.184 € për vitin 2018. Dhe shuma e tërësishme e arkëtuar deri në fund të muajit mars është rreth 1.197.849 € ose 15% e shumës së planifikuar. Sipas kategorive të hyrave vetjake tatimi mbi pronë me 19%. Menaxhimi i mbeturinave me 20%. Pagese në lidhje me automjeteve 22%. Shfrytëzimi i pronës 7%. Lejet e ndërtimit 1%. Lejet komerciale 1%. Këtu duhet të ceket që në krahasim me vitin e kaluar rreth 500.000 € kemi një diferencë më pak. Vitin e kaluar ka qenë diferenca më e madhe është dhe na ndikon shumë. Është inkasomi apo të hyrat nga lejet e ndërtimit që është edhe në bazë të vendimit të gjykatës që është pezulluar plani zhvillimor. Do më thënë në këtë kategori nuk kemi të hyra. Detajet dhe analizat krahasuese i keni në raportet në faqet 6, 7 dhe 8. Të shpenzimet komuna e Prizrenit deri në fund të muajit mars ka shpenzuar rreth 9.100.000 €, sipas kategorive. Në kategorinë e pagave rreth 24% apo 4.800.000 €. Në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve 20%, mbi 1.000.000 €. Në shpenzimet kapitale 14%, afër 150.000 €. Në subvencione me 9%, me 41.380 €. Në investimet kapitale me 17% rreth 3.000.000 €. Në krahasim me vitin e kaluar rreth 449.529 € kemi pasur më pak shpenzime sivjet. Këtu duhet të ceket pasi që është edhe struktura e re, për drejtorët edhe alokimi i mjeteve ka filluar prej muajit shkurt. Kjo është njëfarë difference që prej shkurtit deri në fund të marsit. Në janar nuk kemi pas asnjë shpenzim. Drejtoria e Shërbimeve Publike rreth 2.100.000 €, ka bo një shpenzim. Drejtoria e Arsimit 340.871 €. Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit 312.946 €. Drejtoria e Urbanizmit 97.292 €. Drejtoria e Shëndetësisë 25.299 €. Edhe për investimet kapitale i keni analizat prej faqes 11-14. Shpenzimet nga mallrat dhe shërbimet, në raport i keni për të gjitha kategoritë. Por do t'ju informoj për disa kategori, që edhe kemi diskutua në KPF. Në shpenzimet e udhëtimit brenda vendit. Në total, edhe për administratë edhe për shëndetësi edhe për arsim shuma totale është 82.361 €. Duhet të ceket se këtu është transporti i arsimtarëve dhe transporti i nxënësve. Siç e morën edhe raportin nga Drejtoria e Financave, një shumë prej 58.518 €, qenka një faturë prej vitit 2017 që është paguar. Edhe për sivjet, për këtë periudhë 22.215 €. Shërbimet kontraktuese tjera në total është rreth 469.296 €.

Këtu kemi pasur një pyetje nga KPF-ja, do më thënë cilat janë shpenzimet që përfshihen në këtë kategori. Sa për informatë, është menaxhimi i mbeturinave, mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve, fshirja dhe larja e rrugëve, shërbimet me kontrata të veçanta me shërbime të veçanta. Kontributet të ATK-së. Dekorimi i qytetit për festat e fund vitit. Këto kenë shumat pak më të larta në këtë kategori. Edhe të gjitha shërbimet që i merr komuna nga jashtë të gjitha janë në këtë kategori. Tani vjen furnizim për zyre rreth 52.419 €. Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve rreth 15.886 €. Shpenzimet dhe vendimet e gjykatës 62.086 €. Vendimet e nenit 39.2, 160.974 €. Shpenzimet nga investimet kapitale, ndërtimi i rrugëve lokale mbi 1.000.000 €. Kanalizimi 84.200 €. Ujësjetësi 142.000 €. Mirëmbajtja e investimeve rreth 1.000.000 €. Pagesat e vendimeve gjyqësore në kategorinë e investimeve kapitale rreth 276.779 €. Pagesat e nenit 39.2 të ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë rreth 350.000 €. Totali në këtë kategori të pagesat e përmbaruesit, apo të pagesat e vendimeve gjyqësore është rreth 1.100.000 € kemi paguar deri në fund të muajit mars. Për analizat apo për shënimet tjera e keni raportin, materialin.

Kryesuesi, hapi debatin lidhur me pikën e rendit të ditës.

**Agnesa Sinanaj:** Gjatë analizës të kësaj pike të rendit të ditës dua ti veçoj disa kategori, ku kam vërejtur diferenca të mëdha të shumave në krahasim me vitin e kaluar të këtij tremujori. Të hyrat vetanake është e qartë që ka shumë më pak të hyra krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Në vitin 2017 kanë qenë 1.700.000 €, kurse tash janë 1.100.000 €. 500.000 € diferencë, arsyeja pse. Kurse të alokuara vitin e kaluar kanë 960.000 €, kurse në këtë vit janë vetëm 778.000 €, do më thënë 127.000 € më pak. Çka nënkupton një përformancë të dobët të këtij menaxhmenti. Po ashtu të kjo kategori kam vërejt se edhe të hyrat dhe donacionet e brendshme, participime për periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kanë qenë 126.000 €, ndërsa tani janë vetëm 116.000 €, që i bijnë për rreth mbi 10.000 € më pak se sa periudhën e kaluar. Si dhe të kjo kategori vërej edhe një shifër prej 409.161 €, pra gjysmë milioni si huamarrje. Bazuar në këtë lind pyetja, athua pse është dashur komuna e Prizrenit të thellohet në krizë financiare pasi që vazhdimisht nga ana e juaj ankoheni për borxhe që tashmë komuna është duke u ballafaquar. Atëherë unë mendoj në rast se vazhdohet edhe më tej me këtë ritëm të tillë, kam frikë se mos po na dyfishohen kriza e borxheve. Tek të dalat e komunës shpenzimet edhe pse e keni bo një shkelje ligjore, sepse ky raport është dashtë me ardhur në muajin prill për tremujorsh, e keni prurë këtë muaj. Kam vërejte edhe të hyrat krahasuar me vitin paraprak ishin dukshëm më të ulëta. Ndërsa shpenzimet gjatë analizës tabelare i kam pa që janë dukshëm më të larta. Për shembull tek pagat dhe

mëditje, vërehet që ka një rritje të madhe. Këtu e kam parasysh rritjen e pagave nga Kryeministri që ka ndikua në rritjen e këtyre shifrave. Por ajo çka më ka përshtypje te shpenzimet e udhëtimeve jashtë vendit. Ishte shifra prej 1.387 €, tek Administrata komunale. Ku në vitin e kaluar në po të njëjtin tremujor ishin vetëm 300 €. Do më thënë i bije diku rreth 400% rritje të mëditjeve që i keni bërë, kështu më duet mua në analizë. Do më thënë ju vazhdimisht e kritikoni Qeverinë qendrore për zhvatje të parave publike. Jeni ata që i bëni të njëjtat veprime, ku sigurisht është më lehtë me kritikua, që me ra në sy të qytetarëve, në mënyrë që ata mos me i pa dobësitë e juaja. Te kategoria mallra dhe shërbime. Edhe pse kishim ulje të konsiderueshme të hyrave në krahasim me vitin paraprak. Edhe këtu kemi shpenzime shumë më të larta. Ku në vitin 2017 për periudhën e njëjtë krahasuese ishin vetëm 227.580 €. Ndërsa në këtë vit janë 1.144.141 €. Do më thënë diferencë 916.000 €, më shumë shpenzime. Po ashtu një performancë e dobët e këtij ekzekutivi. Ku vlen mi theksua edhe këto ndryshime të tjera. Te kategoria kontraktuese të tjera në vitin e kaluar për të njëjtën periudhë ishin 28.000 €. Ndërsa këtë vit janë 469.000 €, do më thënë 440.855 € më shumë se sa vitin e kaluar. Jo vetëm mu arsyetua z. Drejtor ku i keni çua këto para, për menaxhimin e mbeturinave, por edhe vitin e kaluar a nuk kanë qenë qeto shpenzime mu bo a? Tek nënkategoria e mobiljeve më pak se 1.000 €. Në vitin e kaluar ishin pothuaj se 3.000 €. Kurse tani janë 11.142 €. Pse kaq shumë për mobilim. Kur ju vazhdimisht ankoheni se komuna është në borxhe të mëdha edhe pa buxhet. Atëherë pse ishte e nevojshme me u shpenzua kaq para për arsye luksoze. Keni mund ndoshta me punua edhe me ato që i keni pas. Ndërsa në sektorin e subvencioneve, nënkategoria e subvencioneve për entitete jopublike në vitin e kaluar janë shpenzuar vetëm 8.100 € ndërsa për këtë vit 40.390 €, do më thënë diferenca mbi 32.000 €. A mund ta di ku janë shpenzuar këto mjete.

**Kryesuesi:** Edhe pse nuk kërkohet ndonjë votim, se këto janë shpenzime, tashme mjete të cilat nuk kthehen. Por ka komuna që po e praktikojnë votimin. Edhe ne po shkojmë sipas asaj procedurës. Atëherë 29 jemi të pranishëm, kush është për?

Për? – 24.

Kundër? – 4.

Abstenime? - 1.

Atëherë konstatojmë se me shumicë votash, 4 kundër, 1 abstenim miratohet raporti financiar të realizimit të Buxhetit Komunal, për tremujorin e parë të vitit 2018.

## **Pika e tetë:**

### **Informatë mbi gjendjen e furnizimit me ujë në Komunën e Prizrenit**

**Kryesuesi**, ftoj përfaqësuesin e Hidroregjionit që të bëjë një prezantim lidhur me gjendjen e furnizimit me ujë

**Ruzhdi Paçarizi, përfaqësuesi i Hidroregjionit:** Fillimisht përpos qytetit të Prizrenit e furnizojmë fshatin Zhur, Vërmicë, Dobrusht, Shkozë, Billushë, Planej, Gorozhup, Milaj, Mazrek, Gjonaj, Kojush, Kabash, Kushnin, Mradem, Vlashnje, Kobaj, Grazhdanik, Nashec, Tupec, Hatmaxhë, Landovicë, Petrovë, Pouskë edhe Serbicë e Ulët. Sa i përket furnizimit me ujë si komuna e dytë në nivel të Kosovës me numër më të madh të konsumatorëve. Lirisht mundemi me thënë që e kemi furnizimin më të mirë në nivel të Kosovës. Deri me tash furnizimit me ujë nuk kemi pas asnjë reduktim sidomos në qytetin e Prizrenit. Mirëpo, tash për shkak të ngritjes së temperaturave të gjithë e dimë se edhe nevoja për konsum rritet. Kështu që përpos që mundemi me pas në do zona ku kemi pas probleme edhe vitin e kaluar. Si p.sh. zona lagja Bazhdarhane, lagja Dardani edhe disa lagje të larta të qytetit të Prizrenit. Sa i përket lagjes Dardania ne vërtetë i furnizojmë tetë orë me ujë të pijes. Mirëpo ata kanë 24 orë furnizim me ujë të pijes, siç e dimë është zonë me shtëpi private dhe secili prej konsumatorëve e posedon depozitën e ujit. Nuk është mirë realisht se duhet 24 orë me i furnizua. Mirëpo tash e kemi një projekt që e ka investua komuna e Prizrenit. Edhe do të bëhet ndarja fizike e furnizimit zona Dardanie me zonën e Bazhdarhanës. Kështu që pas implementimit të këtij projekti po shpresoj shumë që edhe lagja Dardania edhe lagja Bazhdarhane do të furnizohen 24 orë me ujë të pijes. Sa i përket fshatrave deri tash nuk kemi pas probleme me furnizim në fshatra. Mirëpo, tash siç e ceka, ngritja e temperaturave, ngritja e nevojës për konsum. Edhe në qoftë se nuk do të kemi kujdes gjatë shfrytëzimit të ujit të pijes. Pra, mos ta keqpërdorin mos ta shfrytëzojnë ujin e pijes për ujitje qoftë të kopshteve, çoftë ujitje. Atëherë besoj që nuk ka me pas problem edhe nëpër fshatra. Mirëpo, sa më shumë që do të ngritën temperaturat nevoja për reduktime ka me qenë imediate, nuk kemi qare pa bo reduktime. Kështu që është mirë që edhe me ndihmën e juaj si komunë, edhe me ndihmën e inspektoratit që sensibilizohemi edhe të kemi pak më kujdes në mënyrë që të kemi qëndrueshmëri të furnizimit me ujë.

**Haziz Hodaj:** Z. Drejtor unë prita që të jesh sot më ankues para Kuvendit të komunës. Sepse raporti që na dhatë ju, realisht neve do duhej me na qetësua këtu se ka ujë 24 orë në qytetin e Prizrenit edhe në rrethinë 20 orë. Mirëpo, kjo në terren nuk qëndron. Unë dje kam qenë një orë te ju atje edhe kemi diskutua shumë për problematikën e ujit, ku ndër të tjera ceka se ka qenë premtim



elektoral i të gjithë kandidatëve për kryetar komune, që njëherë e përgjithmonë të hiqet nga rendi i ditës problemi i ujit. Problemi i ujit faktikisht ekziston ende, jo vetëm nëpër fshatra po edhe në qytet. Kështu që do duhej ju të jeni më kërkues edhe më bashkëpunues me Kuvendin e komunës. Që në vitin e ardhshëm të parashihet konkretisht një shumë solide buxhetore, e cila do tu garantonte qytetarëve 24 orë ujë. Unë vijë prej fshatit Gjonaj edhe në fshatin Gjonaj kemi vazhdimisht probleme. Kemi pas edhe gjatë periudhës së dimrit kemi pas reduktime e lëre më tani. Po ju do duhej ti kishit mekanizmat tuaj dhe të kontrollonit edhe keqpërdorimin e ujit edhe humbjen e tij e tjera e tjera. Edhe për investime kapitale se duhet me shtua kapacitete të ujit, do tu drejtoheshit komunës për të investua. Sepse na jemi përgjegjës ata të cilët ju garantojnë jetë të mirë qytetarëve edhe furnizim me ujë 24 orë. Kështu që unë po kërkoj nga ju, po konkretisht nga kryetari i komunës, të shikojnë mundësin tani në rishikimin e buxhetit. Ta parashoh, ti përmbledh disa projekte që nuk mund të realizohen. Sepse kemi mjaftë projekte që nuk mund të realizohen brenda vitit sepse ka pozicione buxhetore që nuk garantojnë kryerjen e asnjë projekti brenda vitit. Kështu që është mirë të akumulohen disa prej tyre dhe kryhet një projekt i cili do të ishte në shërbim të qytetarëve. Po kërkoj nga kryetari i komunës që këtë ta bëjë brenda rishikimit të buxhetit. Dhe vitin e ardhshëm do të jemi këtu do të kërkojmë një shumë, shumë më solide buxhetore në mënyrë që njëherë e mirë ta heqim nga rendi i ditës furnizimin me ujë, jo veç në qytet po edhe në fshatrat që ju i menaxhoni. Përndryshe do të ketë probleme, se ju paraprakisht nuk ishit, se pat një raport prej kryetarit, se pat pyetja rreth furnizimit me ujë. Dhe u përmend çështja edhe e Radoniçit. Ju e di që e keni rival sigurisht Radoniçin në furnizimin me ujë. Për atë arsye duhet shumë të kujdesshëm, duhet të jeni shumë konkret në kërkesat tuaja. Në mënyrë që ta shuani atë diferencimin, madje edhe kërkesën që ndoshta edhe shumë fshatra të kryqen në Hidrosistemin e Radoniçit.

**Fatmir Kastrati:** Më vjen mirë që dikush prej hidroregjionit është në asamblenë komunale dhe po raporton gjendjen e ujit në komunën e Prizrenit. Z. Paçarizi unë që prej 2007 jam në këtë asamble edhe vazhdimisht e kam ngrit problemin e ujit në lagjet “11 Marsi” dhe “Dardania”. Edhe që 20 vite po bëhen gati pas lufte këto lagje nuk kanë ujë të pijes. Ndërpritet uji në orën 8:00 lëshohen në orën 15:00 e pastaj edhe kur të lëshohet në orën 15:00 normalisht se nuk ka ujë të mjaftueshëm. Unë raportin e juaj që e keni përgatit edhe nga ajo që dëgjova po thoni se 24 orë furnizohet qyteti i Prizrenit me ujë. Mirëpo nuk e di edhe nuk e kuptova sqarimin pse këto lagje nuk kanë ujë. Unë e di që është një çështje teknike, kam biseduar disa herë me drejtorin e Hidroregjionit. Mirëpo, s’di që 20 vjet kjo çështje teknike nuk ka mundur me u zgjidhë. E nuk

ka prioritete më të madh për ujë. Unë e di që ka edhe prioritete tjera. Mirëpo, asnjëherë nuk i është kushtuar kujdes ku 20000 banor kanë problem me ujën që 20 vite. Nuk është problemi vetëm i temperaturave të larta, sepse edhe në dimër nuk ka ujë. Kërkoj të di se kur do të përfundoj projekti i cili ka filluar. A do të përfundoj këtë vit apo do të vazhdoj kështu edhe 20 vite tjera. Andaj, kërkoj një përgjigje, në qoftë se ke përgjigje. Unë ia kam ngarkua vetës sa herë që kam marrë fjalën kam me ngritë problemin e ujit, sepse nuk ka problem më të madh. Shpresoj që brenda këtij viti do të zgjidhet ky problem në mënyrë që njëherë e përgjithmonë ta heqim nga rendi i ditës. Nuk është problemi vetëm në këto lagje. Unë e di se edhe lagje tjera të qytetit ka problem të ujit të pijes. Unë ju falënderoj edhe për punën që keni bërë. Po shihet që keni punuar shumë. Sepse nuk është lehtë me menaxhuan krejt këtë qytet. Po megjithatë është mirë që bile në këto lagje. Kur thuhet se është çështje teknike dhe ka mjaftueshëm ujë të pijes. Atëherë le të zgjidhet ky problem.

**Pranverim Berisha:** Dua të demantoj drejtorin apo përfaqësuesin e Hidroregjionit Jugor, se gjëja furnizimi ka ndodh dhe po ndodh në fshatin Billushë. Nuk është e vërtetë, kjo është një gënjeshtër e kulluar. Asnjëherë nuk ka ndodhur furnizimi me ujë të pijes nga Hidroregjioni për fshatin Billushë. Do të thotë këtu kemi edhe një kontratë që është lidh më 11.03.2014, në mes të Kuvendit komunal, banorëve të fshatit Billushë dhe Hidroregjionit Jugor. Po kjo teorikisht kjo kontratë qëndron, praktikisht asnjëherë s'ka ndodh. Andaj mos e dezinformoni opinionin sepse furnizimi për fshatin Billushë nga Hidroregjioni Jugor nuk ka ndodh asnjëherë.

**Behar Begaj:** Ju e dini se Zhuri gjithnjë ka pas probleme me furnizim me ujë, atë e dini më së miri të gjithë që jeni këtu prezent. Unë kisha pas një pyetje, se a keni menduar ndonjë variant se si do ta zgjidhni këtë problem njëherë e përgjithmonë. Apo do të vazhdojmë ne gjithmonë me këto akuza me këto kritika, me këto kërkesa, me këto padrejtësi që po i bëhen qytetarëve. Edhe një diçka tjetër. Më sa e di unë ne e bëjmë pagesën edhe të kanalizimeve nëpërmjet atyre faturave të ujës-jellës. Dhe asnjëherë nuk janë marrë parasysh që të pastrohen ato puseta që janë nëpër fshat. Kush i bënë këtë pastrim. Unë një kërkesë ia kam drejtuar Drejtorisë së Shërbimeve Publike. Por mendoj që kjo që mendoj që këtë ju duhet ta bëni këtë punë. Megjithatë në Zhur pothuajse të gjitha pusetat janë të mbyllura.

**Petrit Hoxhaj:** Unë këtu e pash që në fshatin Vlashnje që menaxhohet prej kësaj, dhe ka ujë. Mirëpo, është realiteti që nuk ka ujë. Që tetë vjet radhazi është bërë kërkesa për mu rregullua çështja e ujit, por nuk është rregullua. Unë kam një pyetje për përfaqësuesin apo për drejtorin që kur do të jetë hera e

fundit që ne do të kërkojmë do të thotë çështjen e ujit në fshatin Vlashnje. Ndërsa çështja e Murademës, unë më sa i që këta veç e kanë të zgjidhur këtë prej fshatit Poslisht e marrin ujin me ramje të lirë. Ndërsa për Vlashnje, ne nuk kemi ujë. Është realiteti që nuk ka ujë për arsye sepse gjithmonë komuna ka bërë investime, por investimet kanë qenë të gabuara. Dhe janë pyet kurrë vlashjanët se kah me marrë ujin. I kanë prurë gypat prej qytetit, por gjithmonë nëpërmjet gypave nuk ka ardhur asnjë pikë ujë në fshatin Vlashnje. Kur do të jetë hera e fundit që ne do të kërkojmë ujë na ky institucion. Edhe pse ne jemi taksapagues të rregullt. Edhe pse nuk kemi ujë, për çdo muaj banorët e fshatit Vlashnje e paguajnë tarifën që është e obliguar me ligj me pagua.

**Cenet Sayhadi:** Belediye ile Hidroregjon kurumu arasında bütçe planlaması sürecinde ortak hareket edilmesi gerekmektedir. Kurula, Bazdarhane ve Dardania bölgesinde 15 yıldır su sorunu yaşanmaktadır ve su kullanımının hani gereksiz su kullananlara karşı herhangi bir ceza uygulanıyor mu? Teşekkürler.

**Memnuna Ajdini:** Meni interesuje takode vodocabdevanje Novog naselja, dakle naselja oko škole „Lek Dukagjini“. Obzirom da oni kubure več više desetina godina sa vodom. Da li postoji strategija i plan njihovog probleme.

**Kryesuesi:** A ka dikush tjetër? Nëse nuk ka atëherë ftoj përfaqësuesin e Hidroregjinit të jep përgjigje për anëtarët e Kuvendit.

**Përfaqësuesi i Hidroregjionit:** Do të mundohem të përgjigjem në pyetjet e parashtruara Z. Hodaj, ishe dje tek ne edhe i biseduam këtu çështje shumë mirë na. Kompania jonë e ka një plan të biznesit, i cili është i paraqitur në ueb faqen e kompanisë. Është dorëzuar në zyrën rregullative të ujit. Njëkohësisht është plan i biznesit i unifikuar që të njëjtë e ka edhe Ministria e Zhvillimit të cilin e kemi aksionar. Ne planifikimet tona për secilin vit i planifikojmë edhe mundohemi me i realizua gjithmonë në funksion të buxhetit se sa kemi mundësi prej mjeteve vetanake, që ato janë mundësi shumë të pakta. Po edhe prej egjenconeve tjera financiare. Mos të harroj të them, që edhe dje ju tregova që ne të nderuar i qojmë në fshatin Gjonaj i cili ka rreth 5.500 banorë, 13 litra ujë në sekondë. Sa për informatë të shkurtë 13 litra në sekondë i bije që secilit banorë në ditë ia qojmë nga 200 litra ujë. Besoj që kjo është një matje zonale për gjithë fshatin. Edhe njëherë po them fshatit Gjonaj i qojmë nga 200 litra ujë për banor në ditë. Kurse konsumi normal është që ne e shesim është deri në 120-125 litra, do më thënë më shumë s'harxhon një njeri ujë. Edhe Gjonajt jemi të detyruar me bo nga 6 orë secilës zonë se ndahet në katër zona. Kjo ndodhë thash edhe në fillim, se dikush tha është gënjeshtër. Nuk është absolutisht gënjeshtër se nuk kemi dalë ne këtu me gënjeje. Po është problemi,

thash në momentin e parë që të fillojnë temperaturat e larta nevoja për konsum ka me u rritë. Kurse sa i përket kërkesës sonë, ne kërkesat i kemi bo në të gjitha agjencionet. Po ku është problemi e tregova edhe dje. Ose duhet investim emergjent me bo, me rritë sasinë e ujit se qytetari donë ujë, edhe misioni jonë është me furnizua me ujë. Fshati Gjonaj ka humbje shumë të mëdha si teknike ashtu edhe komerciale në “vjedhje”. Thash e kemi bërë projektin prej vitit 2012 është projekti që rreth 500.000 €, ia kemi dërguar të gjithëve. Patjetër duhet me u ndërrua rrjeti në Gjonaj. Nuk kemi mundësi me mjete vetanake me bo. Tash ju jeni delegat që e përfaqësoni popullin e juaj. Bashkërisht mos të mundohemi për çështjen e fshatit Gjonaj, edhe njëherë e përgjithmonë ta mbyllim problemin në fshatin Gjonaj.

**Hodaj:** Derisa raporti i juaj është furnizimi 24 orë, 20 orë minimumi. Do më thënë është problem me kërkua ne se realisht e kemi furnizimin me ujë. Për qatë po të them unë. Ju duhet të jeni shumë më konkret në kërkesa, që ta realizojmë atë.

**Përfaqësuesi i Hidroregjionit:** Unë raportet e mija i mbroj, se është e vërtetë zotëri. Tash kanë filluar mu ngrit temperaturat, mundem me u bo edhe ma keq, nuk po them që jo. Z. Hodaj rrjeti i fshatit Gjonaj është mos të them komplet jashtë funksionit. Nuk mundesh me arrëna me bo. Janë bo pas çlirimit, po duhet mu ndërrua. E kemi projektin, duhet me bo çmos për me rregullua. Sa i përket pyetjes së z. Kastrati, në lidhje me lagjen “2 Korriku”, unë fillimisht e përmenda që komuna e ka investua këtë projekt, edhe nuk di tash sa keni mund me shkua me pa. Projekti mundet mu krye shumë shpejt. Është projekt i financuar dhe të gjitha procedurat i ka krye komuna e Prizrenit. Tash në qoftë se projekti është i paraparë për mu zhvillua brenda dy viteve për shkak të pagesave. Unë atë nuk e di, sepse është çështje e komunës. Po besoj se projekti si çështje teknike është gati para përfundimit edhe ka ardhur deri te lagja Kurilla. Tash është duke vazhduar është duke u lidh me lagjen Bazhdarhane para derës së KFOR-it. Kështu që shumë shpejt mendoj që ky projekt ka mu realizua. Po çka është më e rëndësishme që ndërlidhet me këtë projekt. Ju siç e dini rrugës për Reçan jemi duke e ndërrua gypin kryesor që ka me pru 500 litra ujë në sekondë në basenin e shpatit, ish pusnicës. Prej atij basenit ka mu furnizua ai baseni mbi që ka me furnizua lagjen Dardania dhe lagjen Bazhdarhana. Dhe në momentin që ndahen këto lagje fizikisht. Sepse ne për mi dhënë ujë Dardanisë, jemi detyruar me ndal pak a shumë Bazhdarhanën. Edhe pse që një kohë të gjatë lagja Bazhdarhana s’ka reduktime. Mundet me pas tash kur rritet konsumi për ujë edhe atë për një kohë shumë të shkurtë. A për konkretisht datën, është plani dinamik, është projekti edhe mundeni me u informua pa problem. Sa i përket pyetjes së parashtruar nga z. Berisha për

fshatin Billushë. Hidroregjioni është kompani e ujësjellësit që i furnizon të gjithë qytetarët të Prizrenit. Gënjeshtër nuk ke nevojë me thënë. Kur i lexova emrat në bazën e konsumatorëve se ekziston fshati Billushë që më ju e kemi një marrëveshje të nënshkruar prej kryetarit të fshatit, kryetarit të komunës edhe neve. Jeni të regjistruar në bazën e konsumatorëve mirëpo nuk na keni lënë me punua. Nuk e di sa të kanë informua ata. Ju kemi thënë ju lutemi vendosni ujëmatës, nuk keni bo kurrëgjë. Për mendimin tim nuk ke informacione. Kishe bo shumë mirë me ardhur në zyre me diskutua këtë punë ne shumë mirë edhe bindesh edhe vet. Përgjigja ime është që kjo. Çka ke me më tepër urdhëro në zyre diskutojmë edhe i hymë komplet dokumenteve prej fillimit. Besoj është për ty më mirë edhe informohesh më mirë. Sa i përket fshatit të Vlashnjës rrjeti është ndërrua në vitin 2010-11 a po pajtohesh. Rrjeti në fshatin Kobaj në vitin 2015, a po pajtoheni. A e dini ju që humbjet në fshatrat e juaj i kemi 85%. A e di që njëjtë si në fshatin Gjonaj i qojmë ka 200 litra për kokë të banorit edhe te ju. A e dini që i kemi zënë 40 lidhje ilegale duke ia lëshua duke ujit arën livadhin, a jeni në dijeni për këto. Me u marrë me qeto probleme, ne të gjithë po jetojmë në qytet të Prizrenit, të gjithë po jetojmë në Kosovës. Të gjithë e dimë qysh është. Edhe tash absolutisht s'po dua me kuptua as nga ana e juaj që mendoni 'sulm'. Po as përgjigjet e mija mos i merrni ashtu. Hajdëni të bëhemi bashkë edhe ti rregullojmë gjërat, ta ndihmojmë njëri tjetrin. Se tek e fundit uji është i të gjithëve, ky është mendimi jem. Ne e kemi ekipin e kontrollues që funksionin me mundësit e veta, s'ka mundësi më shumë. E dini lëndët i qojmë në prokurori i bëjmë kallëzimet penale. Sa ecin, a është puna e Hidroregjionit. Prandaj po them është mirë mu bo një sensibilizim edhe më i madhe në lidhje me çështjen e furnizimit me ujë. Se s'ka çështje më të madhe për qytetin e Prizrenit. Për znj. Sayhadi, më sa më tregoj kolegu mbrapa e kërkove një bashkëpunim. Po e vërtetë është duhet me bashkëpunua, në qoftë se të interesoj lagja Bazhdarhana. Po është e vërtetë që na veç me qet projekt do të zgjidhet çështja njëherë e përgjithmonë. Edhe znj. Memnuna pyetje për "Lek Dukagjinin". Në momentin e parë që do të bëhet ndarja fizike këtë projektin e ri që është duke e zhvilluar komuna, ndarja fizike e lagjes Bazhdarhana me lagjen Dardania. Pjesa e shkollës nuk do të ketë më problem me furnizim me ujë të pijes. Gjithmonë këto probleme po i ceku në kohën, në pikun kur kërkesat janë maksimale për ujë. Përndryshe deri më tani le të thotë dikush që s'ka pas furnizim me ujë, për qytet të Prizrenit po flas. Ne Zhurin e kemi marrë në vitin 2011, dhe diku një borxh i ujit ka qenë rreth 3-400.000 € më duket. Atë punë e ka krye komuna bashkë me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik. Kemi bo mirë që e kemi marrë Zhurin, se edhe tash edhe interesi edhe i qeverisë edhe i gjithë neve duhet që zonat rurale të integrohen patjetër nën kompani të licencuara siç është Hidroregjioni Jugor. Arsye është sepse duhet mu kontrollua uji, duhet mu

kontrollua cilësia e ujit se çfarë ujë po përdor konsumatori. Është e rregulluar me legjislacion që çdo sistem rural më nuk duhet me u menaxhua vetë, po duhet me u menaxhua prej një kompanie të licencuar. Prandaj po them se deri më tani, ti jeton në Zhur jemi takua disa herë. Ne nuk kemi pas reduktime të mëdha në Zhur, tash kanë fillua është e vërtetë. Reduktimet për momentin i kemi katër orë. Sepse po na duhet me forcua lagjen gurishte. Edhe ti e dinë mirë që jem mundua me gjete ujë te mali Korintik. Mirëpo, nuk kemi pas sukses. Prandaj, hajde të bashkëpunojmë prapë nëse ju mendoni që e keni ndonjë ide të mirë për ujin. Hajde urdhëroni po ne jemi të hapur. Na jemi veç në shërbim të tuajin. Përderisa unë e kuptoj se jemi në shërbim të tuajin, absolutisht i keni dyert e hapura. Për kanalizimet, komuna i ka asetet nën menaxhim. Prandaj ne duhet patjetër me bo një grup pune dhe me zgjidhë këtë çështje, që të gjitha asetat që ne i mirëmbajmë, kurse janë aset i komunës së Prizrenit. Këto janë gjëra që duhet mu rregullua në të ardhmen përmes ndonjë takimi. Në momentin që zgjidhet kjo çështje. Konkretisht na bije barra neve tani edhe për pastrimin e kanalizimit. Ne e faturojmë një tarifë të kanalizimit për sasinë që e harxhon. Mirëpo nëse ka nevojë për investim. Ne nuk kemi mundësi me investua, ky është problemi. Ne për momentin e kemi një cisternë shtytëse, që me presion e liron ujin, e hap kanalizimin. Në qoftë se brenda kapacitetit të Hidroregjionit mundet mu krye qajo punë mirë, në qoftë se jo atëherë duhet me gjet tjetër zgjidhje.

**Petrit Hoxha:** A ju ka shkua ndonjëherë ndërmend për fshatin Vlashnje dhe Billushë që mu furnizua nëpërmes gurrës së Poslishtit. Të gjithë e dimë që gurra e Poslishtit ka kapacitet me furnizua pjesën Vrrinit komplet me ujë. Po çka është duke ndodh. Se njëherë vetëm Muradema furnizohet edhe vet Poslishti. Ndërsa pjesa e ujit tjetër shkon derdhet në Lumëbardhë.

**Përfaqësuesi i Hidroregjionit:** Unë mendoj se për këto çështje kemi çka me bisedua shumë, jo vetëm tash po shumë kemi çka me bisedua. Ujë ka Vlashnja ka ujë, Prizreni ka ujë të gjithë kanë unë. Po hajde të mundohemi mos ta keqpërdorim. Edhe pse kemi humbje nëpër fshatra, humbje teknike, humbje fizike, humbje komerciale. Ne prapë s'mund tu lëmë pa ujë. Po prandaj po them se në disa vende duhet me ndërrua rrjeti, në disa vende me u reduktua. Kështu që me u mundua me i reduktua keqpërdorimet. Edhe përmes inspektoratit komunal mundemi me u sensibilizua edhe me u organizua edhe me ndal këto gjërat, se është në të mirën e të gjithëve. Kemi fshatra që i furnizojmë përmes energjisë elektrike, kur ndalet energjia nuk varët prej neve. Kush nuk i beson qetyre dokumenteve urdhëroni e vërtetojmë edhe ekzistojnë instanca tjera. Nuk ka ardhur me arsyetua askënd, kam ardhur me arsyetua punën tonë që jemi duke e bo.

**Kryesuesi:** Falënderoj përfaqësuesin nga Hidroregjioni, i cili pranoj që të jetë këtu në sallë. Të na informoj lidhur me shqetësimet tona që kanë të bëjnë lidhur me furnizimin me ujë në komunën e Prizrenit. Sido që të jetë gjendja lë shumë për të dëshiruar. Kjo ka qenë njëra ndër pikat më të diskutueshme në Kuvend nga të gjithë anëtarët e Kuvendit. Meqë që po hymë tashmë në muajin e hartimit të buxhetit. Lus anëtarët e Kuvendit, shefat e grupeve parlamentare që teje në sa më shumë aktiv në ngritjen e çështjeve që kanë të bëjnë me furnizim me ujin e pijes. Veçanërisht me marrëdhënien e shërbimeve publike. Të cilët kanë pastaj lidhje edhe kontakt me kompanitë, jo vetëm në Hidroregjion, po edhe këtë pjesën që furnizohet nga Radoniçi. Sepse është interes qytetarë. Po hymë në një periudhë mjetë të ndjeshme sa i përket furnizimit me ujë, e që është periudha e verës. Dhe se këtë muaj ta japim maksimumin tonë si anëtarë të Kuvendit për mi ngritë çështjet që janë të rëndësishme sa i përket kësaj teme. Edhe njëherë faleminderit. Temën e diskutimit me ujë do ta kemi prapë. Kjo është hera e parë që një kompani regjionale vjen këtu para Kuvendit raporton. Dhe se këtë praktikë të mirë tash e pas do ta vazhdojmë në të ardhmen.

#### **Pika e nëntë:**

**Shqyrtimi dhe miratimi i propozimvendimit për formimin e Komisionit Komunal të aksionareve nga Komuna e Prizrenit për Ndërmarrjen Publike Lokale, KRM "Eko Regjioni", Sh.A, Prizren**

Në materialet të cilët i keni marrë me rendin e ditës, besoj që keni arritur ti shfletoni. Siç e dini në bazë të ligjit mbi ndërmarrjen publike. Komuna e Prizrenit e cila ka hise në ndërmarrjet publike regjionale. Duhet që në fillim të mandatit të Kuvendit ta formoj komisionin komunal të aksionareve i cili do të përfaqëson komunën në atë ndërmarrje dhe raportin e ndërmarrjes të punës ta sjellë në Kuvend në fund të vitit. Besoj që pjesën ligjore të këtij vendimi i cili vendim nuk ka qenë më herët, nuk është marrë këtu në Kuvend. E keni në preambulën e këtij vendimi, baza ligjore e cila është. Një pjesë të diskutimit ne e kemi bërë edhe në KPF-ca. Dhe mbi bazën e botim aty ka kalua dhe i rekomandohet Kuvendit për votim. Para se me shkua me propozime, siç e dini janë tre anëtar gjithsej që e përbëjnë komisionin komunal të aksionareve. Një e zgjedh apo e emëron kryetari i komunës, kurse dy anëtarë të tjerë duhet të zgjedhën apo të emërohen nga Kuvendi.

**Simir Krasniqi:** E di që jeni lodh ndoshta zgjati shumë. Po unë kam kërkuar edhe në KPF-ca. Të paktën pasi po formohet për herë të parë ky komision. Ne kemi në KPF-ca, po edhe kuvendarët nuk kanë informacione se cili do të jetë roli dhe kompetencat e këtij komisioni. Do të ishte mirë të

raporton Drejtori i Shërbimeve Publike, apo edhe dikush tjetër. Se cila do të jetë kompetenca e këtij komisioni që do ta votojmë ne sot.

**Kryesuesi:** Siç e theksova. Në secilin propozimvendim i cili ju vije si material. Në pjesën e parë këtu, preambula pjesa hyrëse, gjithmonë është baza ligjore. Baza ligjore e cila është referencë në ligjin ku në mënyrë më të detajuar bëhet përshkrimi i kompetencave në qoftë se zgjidhet ndonjë komision i bazës ligjore për me marrë ndonjë vendim, ndonjë çështje që rregullon. Pra të gjitha janë në pjesën e preambulës. Pra e tëra që duhet është ti referohemi edhe ti lexojmë. Sa i përket kësaj është referenca e ligjit për ndërmarrjet publike. Unë e kam këtu, shpresoj që është versioni i fundit, besoj që po. Ku mund ta lexoi nën për nën. Mirëpo, formimi i komisionit të aksionareve tashmë është obligim ligjor. Komunat janë duke e bo. Dhe rrjedhimisht edhe do të ishte edhe ne ta bëjmë. Nëse doni unë mund tua lexoj. Është nis nga neni 5 ushtrimi i të drejtave të aksionarit, ku një komunë është aksionare në një ndërmarrje publike lokale. Të drejtat e saj do të ushtrohen nga një komisionar komunal i aksionareve i cili përbehet nga një anëtar i emëruar nga Kryetari i komunës dhe dy anëtar të tjerë të emëruar nga Kuvendi komunal. Për këtë qëllim komisioni komunal i aksionareve ka të drejtë të veproj në emër të komunës përkatëse. Dhe duhet të veproj në përputhje me ligjin për shoqëri aksionare. Çdo komision komunal i aksionareve duhet me shumicë të thjesht votash të vendos si do të ushtrohen të drejtat aksionare të komunës në një çështje të caktuar. Pastaj vazhdon kjo ende. Neni 6 miratimi dhe zbulimi i politikës së pronësisë. Neni 6.2 brenda 120 ditëve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji komisioni komunal i aksionareve prej secilës komunë do të përgatis dhe nxjerr një politikë të pronësisë, e cila paraqet objektiva të përgjithshme të komunës në lidhje me pronësinë e ndërmarrjes publike lokale. Si dhe rolin e sajë në qeverisjen korporatave të ndërmarrjeve lokale. Kjo politikë e pronësisë duhet të jetë në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe dispozitat e tjera të aplikueshme ligjore në Kosovës. Kjo politikë e pronësisë po ashtu duhet të përmbaj dispozitat e hollësishme mbi mënyrën dhe zbatimin e saj. Nëse më shumë se një komunë posedon aksione në një ndërmarrje publike lokale. Komisionet përkatëse komunale të aksioneve, do të bashkëpunojnë për përgatitjen e një politike të përbashkët të pronësisë. Në rast se marrëveshja nuk mund të arrihet në lidhje me element përmbajtjesor të politikës së përbashkët të pronësisë. Çështja do të vendoset me shumicën e votave. Mund të vazhdoj kështu ta lexoi. Materialet janë referencat janë, kështu që është e çartë. Unë besoj se e keni marrë me kohë. Dhe e keni pas gjithë kohën në dispozicion, që ti shqyrtoni këto. Tash duhet të kalojmë në pjesën e propozimeve. Një anëtar e emëron Kryetari i Komunës, ai emër do të bëhet pjesë e vendimit, ashtu është, siç është paraparë edhe në këtë propozimvendim.



Kurse tash shkojmë në pjesën e propozimeve që i përket Kuvendit. Po nisi me radhë. PDK-ja a ka ndonjë anëtar që e propozon për këtë komision.

**Simir Krasniqi:** PDK-ja e propozon Alush Shalën.

**Adem Shabanaj (LVV):** Propozimi jonë do të jetë në emër të koalicionit dhe të shkojnë dy emra: Petrit Hoxhaj dhe Karanfil Haxhillari.

**Agnesa Sinanaj:** Ne e propozojmë Fatmir Kastratin.

**Fatmir Kastrati:** A do të shkon me vota kjo apo si. Vetëm dy shkojnë janë pesë propozime.

**Kryesuesi:** Kuvendi mund ti propozoj, ta zëmë ndoshta edhe 5-6. Mirëpo, dy anëtar të cilët marrin më së shumti vota ata anëtar bëhen pjesë e komisionit.

**Adem Shabanaj:** Propozimi i koalicionit, më sa e di unë duhet me shkua ë paket votimi.

**Kryesuesi:** tash dy propozime, në koalicion sa jeni gjashtë parti. Në vend të gjashtë propozimeve i keni bo dy apo. Tash a ka ndonjë propozim tjetër? Nëse nuk ka atëherë shkojmë sipas radhës së propozimeve.

**Simir Krasniqi:** Në qoftë se më lejohet. Nuk kemi nevojë të hymë në votim. Pra një prej opozitës dhe një nga pozita. Besoj që pajtohen edhe s'kemi se çka e hedhim në votim. Një nga pozita dhe një opozita.

**Kryesuesi:** Unë i marrë vetëm propozimet e Kuvendit.

**Shabanaj:** Fortë mirë thuhet edhe në ligj, anëtarët e komisionit të aksionarëve zgjidhen me shumicë të thjesht votash. Dhe në këtë rast dy zgjidhen nga radha e asamblesë komunale dhe një propozim nga Kryetari. Hymë në votim tash. Në qoftë se i kemi propozimet një nga një hymë në votim. Ata të cilët marrin më shumë vota ata dy edhe përzgjidhen.

**Kryesuesi:** Atëherë pra shkojmë një nga një. Propozimi i parë është për Alush Shalën. Jo, jemi në procedurë, besoj që e sqaruam këtë çështje. Të gjitha propozimet një nga një duhet të shkojnë. Urdhëro, vetëm po kalojmë në procedurë të votimit.

**Agnesa Sinanaj:** Ani hiq s'po votojmë, se ata janë shumicë edhe ashtu po dihet që kanë me shkua dy të atyre. Mos na mundo bile hiq.

**Kryesuesi:** Procedura duhet mu respektua, nuk e di kush shkon.

**Sinanaj:** Jo po dihet se ata janë plot, ne këtu veç pesë, gjashtë veta.

**Kryesuesi:** Mirë, atëherë vazhdojmë sipas procedurës së votimit. Të njëjtën procedurë të votimit ne e kemi bërë edhe me komisionin të fshatit Zym. Dhe MAPL-ja ka kthyer përgjigje pozitive, kur është ngritur çështja e mënyrës së votimit. Prandaj më qenë se jemi me dy anëtarë. Nëse doni edhe një orë, dy mi humb. Kjo procedurë është komplet në rregull. Ka përgjigje pozitive nga Ministria. Dhe kështu që vazhdojmë më qenë se kemi të bëjmë me dy anëtarë.

Kush është për propozimin e parë Alush Shala? – 8.

Propozimi i radhës Petrit Hoxhaj, kush është për? – 22.

**Bardhi Avdaj:** Më fal a bënë dy herë me votua a jo.

**Kryesuesi:** Po, po dy herë.

Tani kalojmë te propozimi i radhës Karanfil Haxhillari, kush është për? – 22.

Tani kalojmë tek propozimi Fatmir Kastrati, kush është për? – 9.

Sipas rezultatit të votimit me 22 vota Petrit Hoxha emërohet si anëtar i komisionit komunal të aksionareve. Pastaj në radhë vije Karanfil Haxhillari me 22 vota. Dhe në radhë është Fatmir Kastrati me 9 që nuk kalon dhe z. Alush Shala nuk kalon. Pra dy anëtarë janë të zgjedhur në komisionin komunal të aksionareve për ndërmarrjen publike lokale EKO Regjioni, janë Petrit Hoxhaj dhe Karanfil Haxhillari.

### **Pika e dhjetë:**

**Shqyrtimi i propozimvendimit për ndryshimin dhe plotësimin-riparcializimin e Planit Urban (tani të hollësishëm) për shpalljen e zonës së veçantë për Industri të Lehtë (të mesme dhe të vogël) “Parku i Biznesit”.**

I cili është futur si propozim nga Drejtoria e Urbanizimit të mbështetur nga kryetari i komunës, në mbledhjen e fundit të KPF-ca. Ky propozim vendim i cili është dërguar pas mbledhjes edhe në imellat e juaj zyrtarë. Ka të bëjë me iniciativën për hartimin, apo për bërjen e riparcializimit të pjesës në zonën u është paraparë ndërtimi i parkut të biznesit. Siç e dini para disa dite në Prizren kemi pas vizitën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës. Ku njëra ndër temat në diskutimin me kryetarin e komunës, ka qenë edhe parku i biznesit. Ai është zotuar që do ta kryej çdo punë e cila është në kompetencën e tij. Dhe se ka ofruar mbështetje edhe kryetarit të komunës edhe Kuvendit për realizimin e këtij projekti. Ky projekt siç e dini është një përpjekje e kahershme e komunës së Prizrenit. Prej datës 29 shkurt të vitit 2012. Ka hasur në shumë vështirësi, ka

hasur në shumë pengesa ligjore. Ka pasur shumë konteste pronësore. Ka pasur shumë paqartësi juridike mbi pronësinë. Siç e dini deri në mandatin e kaluar në qoftë se ka këtu ndonjë anëtar ku ka qenë problemi kryesor. Gjë që tashmë është diskutua edhe me Kryeministrin e Republikës së Kosovës. Që statusi i pronave të armatës jugosllave, e cila duhet në këtë rast ti kaloj në shfrytëzim komunës së Prizrenit. Apo në pronësi, sido që të vendoset më qëllim të realizimit të këtij projekti që është jetik, jo vetëm për komunën e Prizrenit, po për ekonominë e Kosovës. Unë e ftoj fillimisht drejtorin, që ta bëjë një prezantim para Kuvendit lidhur me propozimvendimin, dhe pastaj fjalën ia kalojmë anëtarëve të Kuvendit.

**Fatmir Memaj, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm:** Atëherë siç e ceku kryesuesi, do më thënë e elaboroj një pjesë të këtij propozimi. Nga nevoja e cila ka lindur për shpalljen e zonës Parku i biznesit, zonës industriale. E cila gjendet në mes të fshatit Korishë dhe Lubizhdë. Me të cilin vendim është shpallur qysh në vitin 2012 si Park i biznesit. Edhe me këtë vendim bëhet lejimi i inicimit të procedurave të ndryshimit dhe plotësimin në riparceliazimin e ngastrave kadastrale të cilat gjenden në kuadër të vendimit 2340 të datës 29 shkurt 2012. Me të cilin është miratuar plani rregullues urban atëherë është quaj. Tash quhet plan rregullues i hollësishëm për shpalljen e zonës së veçantë të industrisë së lehtë, të mesme dhe të vogël Parku i biznesit. Siç e dini pjesë përbërëse për ata kuvendarë që kanë qenë më herët gjatë kësaj kohe kur është miratuar ky plan. Pjesë përbërëse e këtij plani janë dy pjesë kryesore. Pjesa tekstuale dhe pjesa grafike. Në pjesën tekstuale parashihen kushtet për rregullimin dhe destinimin e ndërtimeve në këtë hapësirë. Ndërsa pjesa grafike përmban paraqitjen grafike të këtij plani rregullues urban, tani i hollësishëm. Të cilat do duhej të riparcializohen. Planin rregullues urban i hollësishëm për të zonës për industri të lehtë dhe të mesme. Përfshinë lokacionin që gjendet në verilindje të qytetit të Prizrenit edhe i cili është në sipërfaqe për rreth 80 hektar. Janë të cekura të gjitha ngastrat kadastrale, të cilat gravitojnë në nenin 4 të këtij propozimvendimi janë të cekura të gjitha ngastrat kadastrale, mos ti përmendi me numra. Ky plotësim ndryshim për riparcializim nevojitet për shkak të vazhdimit të procedurave të mëtutjeshme. Siç është licencimi i parkut të biznesit. Destinimi i ngastrave për të cilat do të aplikojnë bizneset. Kjo procedurë do përfshi edhe debate publike. Do të përfshi edhe dhënie tender të hartimit të këtij projekti të parcializimit dhe në fund do të silltet prapë në Kuvend pas shtjerrjes së procedurave të debatit. Do të silltet prapë në Kuvend. Edhe do të prezantohet para jush si propozim final për riparcializim. Prandaj ju ftoj që ta mbështetni këtë propozim vendim.

**Kryesuesi:** Po shkojmë me shefa të grupeve.

**Simir Krasniqi:** Ne si grup parlamentar i PDK-së e mbështesim këtë propozimvendim.

**Adem Shabanaj:** Edhe LVV-je e mbështet.

**Haziz Hodaj:** Sigurisht që e mbështesim dhe kërkojmë me këmbëngulësi që të implementohet sa më shpejt që është e mundur ky projekt.

**Fatmir Kastrati:** Edhe AAK-ja e mbështet.

**Pranverim Berisha:** Gjithashtu edhe Nisma Socialdemokrate e mbështet.

**Sencar Karamuço:** Edhe ne si KDTP do ta mbështesim.

**Memnuna Ajdini:** Takode i koalicionit Vakrat prihvata.

**Samra Ilijazi:** Takode i NDS prihvata.

**Kryesuesi:** Atëherë e hedhim në votim.

Kush është për këtë propozimvendim? – Unanimisht të gjithë anëtarët prezent në sallë që janë.

Kundër? – S’ka.

Abstenim? – S’ka.

Atëherë konstatoj se Unanimisht është miratua propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin-riparcializimin e Planit Urban (tani të hollësishëm) për shpalljen e zonës së veçantë për Industri të Lehtë (të mesme dhe të vogël) “Parku i Biznesit”.

### **Pika e njëmbëdhjetë:**

**Informatë mbi Draft rregulloret si: 1. Draft rregullorja për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, 2. Draft rregullorja për regjistrimin e fëmijëve në klasën e parë të shkollës fillore 3. Draft rregullorja për rendin ditor të shkollës, 4. Draft rregullorja komunale për vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore dhe funksionimin e ekipit vlerësues pedagogjik dhe 5. Draft rregullorja komunale për nxënësit e riatdhesuar.**

Mund drejtori në pika të shkurta ta bëjë një prezantim të shkurt. Edhe pse me udhëzimin e ri administrativ nuk kërkohet sikurse më herët Kuvendit ta jep pëlqimin që një draftrregullore të shkojë në shqyrtim publik. Tashmë ato direkt

mund të shkojnë në diskutim publike. Të pasurohen me propozimet që bëhen në diskutimet me grupe të ndryshme me qytetarë, pavarësisht siç bëhet ajo formë e organizmit dhe prezantimit të draftit. Dhe kur të plotësohet nga këto shqyrtimet apo diskutimet, vije versioni final në Kuvend ku do ta votojmë. Drejtor fjala është e juaja për më konkretisht.

**Skender Susuri, drejtor i Drejtorisë për Arsim:** Unë fillimisht kërkoj falje që s'kam marrë pjesë në mbledhje të KPF-ca. Ne kemi fillua bashkë me Kuvendin edhe me të gjithë me ndërtua bazën ligjore në aspektin komunal. I kemi procedua katër rregullore, do të mendojmë mi procedua edhe tri që janë themelore njëra na ka marrë kohë. E dini ju që kam kërkuar kohë deri në qershor. E cila është një rregullore kryesore, që ka të bëjë me adresimin e dhunës fizike, emocionale, drogave, alkoolit e kështu me radhë. Dhe një rregullore tjetër që ka të bëjë me rregullat e shkollës. Ku përcaktohen të drejtat përgjegjësitë, duke filluar nga drejtori deri te punëtori teknik. E the edhe kryesuesi që këto rregullore do të dalin në debat. Unë nuk e kam ditë që mund të shpërndahen pa miratimin e Kuvendit, nuk e kam ditë këtë ndryshim. Pas kësaj seance ne do ti shpërndajmë nëpër shkolla. Do të marrim opinionet e mësimitdhënësve dhe personelit udhëheqës. Do të kthehem në Kuvend. Por unë e kam edhe një propozim kryesues, se e kam dorëzuar më herët me shkrim. Po sigurisht që ti i ke ato procedurat e tua. Kishte me qenë mirë që ky Kuvend përfundimisht ta themeloj komisionin për arsim. Në mënyrë që unë të bashkëpunoj më shumë me këtë komision. Dhe para çdo rregullore që e bie në Kuvend, fillimisht mu konsultua me komisionin për arsim. Ju i keni lexuar ndoshta këto tekste. Nuk janë perfektë. E para ka të bëjë me një rend ditor që duhet me u plotësua e cila e një rend ditor. Ama qeto pikat elementare mi pas. E dyta ka të bëjë me regjistrimin e fëmijëve. Kjo sidomos Haziz është shumë e ndjeshme në qytet. Ku neve na rrezikohen shkollat, duke mos respektuar zonat zonale. Dhe kjo rregullore taksativisht e tregon se duhet mu respektua. Edhe pse ligji e thotë. Dhe i cili është autoriteti duke filluar prej zyrës ligjore deri te drejtori për mos me na mbet asnjë fëmijë pa u regjistruar. E treta është një kategori që lypet detyrimisht me bo nxënës të riatdhesuar kur vinë si duhet me u sistemua në shkolla. Katër është një rregullore që ka funksionuar një ekip komunal nuk e di a e dini a jo. Mirëpo nuk e ka pas një rregullore të tillë dhe nuk është kompensua, kjo nuk ka pas seli e kështu më radhë. Kjo rregullore është e harmonizuar me legjisllacionin e ri. Ky ekip komunal që do të formohet normal e ka një çelës aty. Do ta ketë një seli të vetën dhe do të jetë bashkëpunues me ato shërbimet psikologjike për të cilat ne po themi se nuk i kemi në shkollat tona. Kur të vijmë në qershor ose në korrik kur e përgatiti unë këtë. Më siguri se do të diskutojmë edhe do ti plotësojmë edhe do ti bëjmë më complete.

**Kryesuesi:** Para se të kalojmë në këtë, i mbetëm borxh edhe sponsorisuesve të rregullores për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Në qoftë se mundet dikush, znj. Mybexhele Zhuri. Së paku një prezantim të shkurt para Kuvendit se për çka është fjala.

**Mybexhele Zhuri:** Në legjislacionin e Republikës së Kosovës, është e përfshirë konventa për të drejtat e fëmijëve. Dhe në këtë mënyrë faktikisht është edhe drejtpërsëdrejti e zbatueshme në Kosovë. Dhe pjesa më e madhe e legjislacionit i përfshinë principet dhe dispozitat themelore të konventës të drejtave të fëmijëve. Andaj në zbatimin e konventës i kontribuon legjislacioni ekzistues në të gjitha aktet tjera nënligjore. Të cilat prekin çështjet e fëmijëve në fusha të ndryshme. Siç janë arsimi, shëndetësia, mirëqenia sociale, mbrojtja në format e rrezikshme të punës, drejtësia etj. Përpjekjet për ti harmonizuar ligjet, politikat, strategjitë dhe aktet shtesë me këtë konventë. Janë indikatorë kyç të përkushtimit të Qeverisë, për të siguruar dhe garantuar realizimin e plot të të drejtave të fëmijëve në Kosovë. Në këtë drejtim janë miratuar një sërë ligjesh. Ndoshta është mirë disa veç me i përmend sa për dijeni. Ligji për fëmijë, ligji për shërbime sociale dhe familje, ligji për edukim parashkollor, ligji mbi arsimin fillor dhe të mesëm, ligji për arsimin dhe arsimin profesional, nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri, ligji për trashëgimi, ligji penal për të mitur të Kosovës, ligji për përkrahje materiale të familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme. Dhe një sërë ligje të tjera të cilat në mënyrë të drejtë apo tërthorazi ndihmon të drejtën e fëmijëve. Ne jemi në pritje të miratimit të ligjit për mbrojtjen e fëmijëve në Parlamentin e Kosovës. I cili do ti rregullon shumë çështje dhe do të garanton siguri. Dhe do ti mbron fëmijët prej të gjitha formave të dhunës fizike, mendore apo abuzimet të tjera. Do të garanton mirëqenie dhe të siguron masa për ti siguruar fëmijës për të ushtruar të drejtave në përputhje me zhvillimin gradual të aftësive. Dhe shumë çështje tjera, të cilat po presim që ligji së shpejti të miratohet. Sepse ka kaluar leximin e parë, tash është veç në lexim të dytë. Dhe do të jetë shumë i detajizuar dhe shumë gjithëpërfshirës. Andaj si zbatues të obliguar të konventës të të drejtave të fëmijëve edhe komuna i ka përgjegjësitë përgjegjësit e veta. Dhe kjo na obligon që përmes politikave të përshtatshme zhvillimore të krijojmë mekanizma për mbrojtjen adekuate të drejtave të fëmijëve. Komuna jonë është përpjekur që ta harton këtë rregullore për mbrojtjen e fëmijëve. Ku janë të përfshira obligimet e organeve komunale përmes masave dhe veprimeve të ndermirën gjithsesi në frymën e konventës për të drejtat e fëmijëve. Ju e keni marrë materialin dhe sigurisht draftin e keni lexuar. Unë besoj që pash shqyrtimit të të njëjtës do të jepni edhe sugjerimet edhe propozimet e juaja që të shkojmë pastaj në debate publike. Do ti marrim gjithashtu edhe propozime prej qytetarëve. Besoj se në

fund do të dalim me një rregullore e cila do të na ndihmon punën e të gjithë neve. Në rend të par të zbatimit të ligjeve dhe konventës së sidomos për të drejtat e njeriut, e cila është e obligueshme për Republikën e Kosovës.

**Kryesuesi:** Fjalën e ka kërkuar z. Fatmir Kastrati. Kjo është vetëm një informatë Kuvendit që i jepet. Nuk ka procedurë votimi. Eventualisht ndonjë anëtarë i Kuvendit që ka ndonjë propozim mund ta bëjë këtu. Por të gjitha këto dreftrregullore do ti kemi përsëri këtu në Kuvend për ti miratuar versionet e tyre.

**Fatmir Kastrati:** Unë sa për informatë. Nuk i kemi asnjëri po më duket këto dreftrregullore. Nuk e di, në adresën elektronike nuk kanë ardhur. Nuk e di tek tjerët a kanë ardhur. Prandaj jemi totalisht të pa informuar. Po e falënderoj znj. Zhuri edhe drejtori që na informuan. Po pa e pas si material, absolutisht s'kemi edhe çka diskutojmë. Po më siguri se do të na vijë më vonë materiali.

**Kryesuesi:** Po patjetër. Draftet e kemi diskutua a duhet ti dërgohen anëtarëve të Kuvendit. Po më qenë se ende janë në version të papërpunuar. Arsyja pse e kemi pru këtë informacion në Kuvend. Është që të inkuadrojmë anëtarët e Kuvendit të jenë pjesë e shqyrtimeve të debateve publike pasi të bëhen njoftimet nga drejtoritë përkatëse, apo sponsorisuesve të rregulloreve. Natyrisht unë mund të ua dërgoj draftet ndërkohë të gjitha. Veç se janë të papërpunuara. Duhet me pa pas parasysh. Edhe ato do pasurohen edhe në debate publike. E veçanërisht me propozimet e juaja që vinë si anëtarë të Kuvendit. Edhe njëherë falënderoj znj. Mybexhele Zhuri nga zyra për barazi gjinore. Falënderojmë Eleonora Fetollarin nga zyra për integritet evropian. Gjithashtu falënderojmë veçanërisht edhe drejtorin Arsim. Ju dëshirojmë punë të mbarë dhe ju urojmë që këto rregullore sa më shpejt të kalojnë. Dhe krejt në fund ju e patë, ju kemi dhënë CD të cilat në të gjinden të gjitha pronat e komunës së Prizrenit. Të cilat janë të evidentuara në mënyrë elektronike. Është obligim i secilit anëtarë i Kuvendit ta ketë një kopje të tillë. Edhe njëherë ju faleminderit për pjesëmarrjen tuaj në këtë seancë edhe Të gjithë anëtarët e Kuvendit i falënderoj për pjesëmarrje në këtë seancë. Dhe mirupafshim në seancën e radhës.

Të gjithë anëtarët e Kuvendit i falënderoj për pjesëmarrje në këtë seancë. Dhe mirupafshim në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit.

Përfundoi në orën 15:10.

Procesmbajtës;  
Sehat Krasniqi

Kryesuesi i Kuvendit  
Artan Abrashi